REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.01.2023)

***Pika 1 e rendit të ditës me objekt**:* Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2021, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:34.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***
11. ***Yllka Rupa*** ***(anëtare)***

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

5. Të tjerë: Edmond Hoxhaj.

6. Valbona Bala, eksperte (EWMI-INL).

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional, të gjyqtarit {...}, për vitin 2021, relatore znj. Brikena Ukperaj.

Çelet seanca plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor me çështjen e parë në rendin e ditës e cila lidhet me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për vitin 2021, me relatore znj. Brikena Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Gjyqtari {...} i cili ka aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2013–2016, gradimi, vendim i cili është miratuar nga ana e Këshillit. Ndërkohë, si vlerësim i dytë i tij është vlerësimi i përshpejtuar i detyruar, që përkon me vitin kalendarik 2021.

Projektraporti i vlerësimit është përgatitur, i është njoftuar gjyqtarit, bashkë me raportin analitik të përgatitur nga nëpunësja përgjegjëse për vlerësimin. Brenda afatit gjyqtari ka paraqitur edhe objeksionet/kundërshtimet e tij, të cilat gjithashtu janë vënë në dispozicion anëtarëve të Këshillit, para caktimit të datës së mbledhjes plenare.

Projektraporti i vlerësimit shoqërohet nga raporti analitik që është pjesë përbërëse e tij.

Në pjesën e parë të këtij projektraporti shpjegohet e gjithë procedura e ndjekur për vlerësimin e gjyqtarit, e cila ka filluar me vendimin nr. 118, datë 29.03.2022 si një gjyqtar për të cilin ishin plotësuar kriteret ligjore të kandidimit për ngritje në detyrë.

Në pjesën e parë të procedurës shpjegohen të gjitha hapat procedurale të ndjekura nga ana e relatorit, procedurë e cila përfundon me vendimin e datës 12.07.2022 të Komisionit që ka vlerësuar plotësimin e procedurës dhe procedurave të ndjekura nga ana e relatorit dhe ka vendosur vijimin e procedurës së vlerësimit me hartimin e projektraportit të vlerësimit.

Në kushtet kur raporti analitik shpjegon në mënyrë të detajuar të gjithë përmbajtjen e burimeve të vlerësimit, në vijim unë do të ndalem kryesisht në gjetjet dhe propozimet e mia si relatore e kësaj procedure vlerësimi, për secilin nga katër kriteret e vlerësimit.

Për sa i përket kriterit të "Aftësive profesionale", aspekti i "Njohurive ligjore", treguesi "Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave".

Nga analiza e burimeve të vlerësimit është konstatuar se gjyqtari i kushton rëndësi të veçantë përshkrimit të detajuar të rrethanave procedurale dhe të fakteve të çështjes, përshkrim i cili zhvillohet duke iu referuar provave të administruara gjatë gjykimit në shkallë të parë, por duke i analizuar ato në mënyrë të pavarur gjatë trajtimit të ankimit. Kështu, gjyqtari kujdeset që përshkrimin e rrethanave të çështjes ta realizojë duke integruar provat mbi të cilat fakti ekstraktohet. Në këtë mënyrë, faktet evidentohen lehtësisht në vendim.

Pavarësisht, nëse shkaqet e ankimit konsistojnë ose jo në përcaktimin e saktë të rrethanave të faktit, gjyqtari i përshkruan dhe analizon ato në çdo rast, duke bërë të qartë faktin në tërësinë e tij, për të vijuar më pas me analizën ligjore bazuar mbi shkaqet e ankimit. Vetëm në një rast evidentohet se gjyqtari nuk është ndaluar në trajtimin e fakteve të çështjes, pasi për shkak të rrethanave procedurale të ngritura në ankim vendimi kundërshtohej vetëm një vendim për pushimin e gjykimit. Në këtë mënyrë, gjyqtari është ndalur në trajtimin kronologjik të ecurisë procedurale të çështjes gjatë gjykimit në shkallë

të parë, duke vlerësuar më pas nëse vendimi i pushimit është marrë në përputhje me ligjin procedural.

Për sa i përket identifikimit të natyrës së çështjes, referuar të gjitha vendimeve të analizuara, rezulton se natyra juridike e çështjes është e qartë. Megjithëse gjyqtari nuk ndalet në trajtimin e mëvetësishëm të saj, natyra juridike e çështjes, zbulohet rast pas rasti duke iu referuar mosmarrëveshjes në gjykim, si dhe ligjit të aplikuar për zgjidhjen e saj. Gjithashtu, ajo citohet në pjesën hyrëse të vendimit përkatës apo në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese, ku gjyqtari parashtron konkluzionin mbi vendimin e gjykatës së shkallës së parë (duke specifikuar "gjykim civil apo penal").

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, evidentohet se, në të gjitha rastet, duke i ndarë vendimet në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, identifikohet jo vetëm ligji i zbatueshëm material, por atij procedural lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por njëkohësisht bëhet edhe interpretim abstrakt i tij para se të kalohet në zbatimin e tij mbi shkaqet e ngritura të ankimit.

Për sa i përket, në projektraportin e vlerësimit, në mënyrë analitike shpjegohet dhe është pasqyruar fakti i citimit dhe interpretimit të ligjit si në çështjet civile ashtu edhe në ato penale sipas natyrës së ligjit material apo ligjit procedural. Gjithashtu, në disa vendime, gjyqtari referon edhe në aktet ndërkombëtare, të cilat janë të cituara në projektraportin e vlerësimit, ku me "footnote" gjeni të pasqyruara edhe vendimet përkatëse.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira për identifikimin dhe analizën e qartë dhe të plotë të fakteve të çështjes, identifikimit të normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e saj. Për këtë arsye, në cilësinë e relatores kam propozuar që niveli i vlerësimit të jetë "shumë i lartë", duke u pikëzuar me 25 pikë.

Për sa i përket "Aftësisë për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes", në projektraport janë pasqyruar të gjitha ligjet e cituara në vendimet e analizuara si dhe interpretimet e tyre referuar natyrës përkatëse të gjykimit. Njëkohësisht, referohen në

projektraport edhe vendimet në të cilat gjyqtari, përveç interpretimit të ligjit, ka përdorur edhe jurisprudencën relevante referuar shkaqeve të ngritura në ankim.

Si konkluzion, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit të ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me zgjidhjen e çështjes dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën relevante gjyqësore, parimet e përgjithshme të së drejtës dhe standardet e procesit të rregullt ligjor. Në mbështetje të analizës juridike të çështjes, gjyqtari referon edhe në qëndrime të doktrinës lidhur me koncepte të caktuara juridike, duke i dhënë vlerë të shtuar dhe duke qartësuar kuptimin e ligjit të zbatueshëm. Këtij të fundit në të gjitha vendimet e analizuara i bëhet një zbërthim abstrakt i çdo elementi, bazuar në qëllimin e normës juridike, mbi të cilin gjyqtari bazohet për t' i dhënë përgjigje shkaqeve të ngritura në ankim. Për këtë arsye, edhe për këtë tregues është propozuar nivel "shumë i lartë" i vlerësimit, pikëzimi me 25 pikë.

Për sa i përket aspektit të dytë, që ka të bëjë me "Arsyetimin ligjor", treguesin e "Qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit". Në tërësi, referuar vendimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Gjuha e përdorur dhe mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit, mundësojnë lexim të organizuar që ofron kalime nga njëra pjesë e vendimit tek tjetra, në mënyrë logjike. Pjesët e vendimit përgjithësisht fillojnë me një fjali tematike, e cila shpreh idenë kryesore të mendimit të asaj njësie ose konkluzionin mbi të cilin shtjellohen argumentet mbështetëse. Kjo mënyrë e të shkruarit i shërben jo vetëm qartësisë dhe kuptueshmërisë së vendimit, pa përsëritje dhe rikthim në çështje të analizuara më parë, por dëshmon qëndrueshmëri dhe rrjedhshmëri të paraqitjes së argumenteve ligjore. Për këtë arsye, edhe për këtë tregues, propozohet shkallë "shumë e lartë" e aftësisë, pikëzimi me 15 pikë.

Lidhur me treguesin tjetër të këtij aspekti, "Strukturën e qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit", referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në raportin analitik, rezulton se gjyqtari ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimeve. Vendimet objekt vlerësimi përmbajnë një strukturë të tillë që,

fillon me pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese dhe dispozitivin e vendimit. Në relacion gjenden në mënyrë më të hollësishme të gjitha argumentet që pasqyrojnë në secilën pjesë të vendimit.

Referuar kësaj analize konstatohet se gjyqtari ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor, zbaton rregullat e shkrimit ligjor, kryesisht sipas metodës "CRAC (krak)", duke paraqitur në fillim konkluzionin mbi bazueshmërinë e vendimit objekt ankimi, dhe më pas duke analizuar rrethanat e faktit, ligjin e zbatueshëm, argumentimin ligjor lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, për të përfunduar me konkluzionin tërësor mbi bazueshmërinë e tyre. Gjithashtu, konstatohet se vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural përkatës. Konkretisht, vendimet civile përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenin 466 të K.Pr.Civile, ndërsa vendimet penale përmbajnë elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale.

Konkluzion: Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit, duke ndjekur rregullat e shkrimit dhe arsyetimit ligjor. Gjyqtari përdor një metodologji të unifikuar në strukturimin e vendimit edhe pse jo, në aspektin vizual gjithmonë e dallueshme, metodologji e cila i jep rrjedhë logjike analizës dhe argumentimit. Për këtë arsye është propozuar shkallë e aftësisë "shumë e lartë", duke u pikëzuar me 10 pikë.

Për sa i përket treguesit të fundit të këtij kriteri, që është "Cilësia e analizës dhe e argumentimit logjik", në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton që gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin "Cilësia e analizës dhe argumentit logjik". Gjyqtari analizon në mënyrë të plotë dhe të qartë faktet e çështjesh, për të vijuar me analizën e koncepteve ligjore që i shërbejnë zgjidhjes së çështjes, mbi bazën e një zhvillimi dhe argumentimi logjik mbi mënyrën e aplikimit të tyre mbi rastin në shqyrtim. Gjyqtari e zhvillon argumentimin e tij duke ndjekur logjikën e zhvillimit e marrëdhënies shkak-pasojë si dhe duke u kujdesur për të marrë në analizë dhe për t'i dhënë përgjigje të argumentuar të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse (të ngritura si shkaqe në ankim apo në kundërankim), duke

përmbushur të standardin e procesit të rregullt ligjor. Për këtë arsye, edhe për këtë tregues, propozohet shkallë "shumë e lartë" e aftësisë, pikëzimi 25 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e parë të "Aftësive profesionale të gjyqtarit", propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket kriterit të dytë "Aftësitë organizative të gjyqtarit", treguesi i "Respektimit të afateve ligjore". Nga një analizë matematikore e bazuar në statistika, rezulton se nga 158 çështje për të cilat ligji procedural parashikon afat ligjor shqyrtimi në Gjykatën e Apelit, nga të cilat 32 çështje kanë përfunduar tej këtij afati. Ndërkohë, nga analiza logjike e të gjitha të dhënave, duke përjashtuar bazuar edhe në formularin dhe kundërshtimet e gjyqtarit (formularin e vetëvlerësimit të gjyqtarit), ka rezultuar se nga 158 çështje, duke zbritur çështjet të cilat janë analizuar në projektraport si çështje të vendosura jo tej afatit procedural, ka rezultuar se në fakt nga 158 çështje, vetëm 20 prej tyre ose 12% të çështjeve që parashikojnë afat ligjor për përfundimin e tyre, kanë përfunduar tej afatit ligjor. Kjo përqindje pikëzohet sipas metodologjisë, me 12 pikë.

Gjyqtari në Formularin e Integruar të Vlerësimit ka argumentuar shkaqet që kanë ndikuar në numrin e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, duke u ndalur fillimisht në një analizë të përgjithshme, e më pas në analizën e disa prej çështjeve në mënyrë të veçantë. Referuar shkaqeve të përgjithshme, gjyqtari ka vendosur theksin: (i) së pari, tek fakti se në Gjykatën e Apelit Durrës, në vitin 2021, nuk ka pasur dhe nuk ka ndarje në dhoma penale dhe civile dhe, në këtë kuptim, ai ka gjykuar çështje të natyrave të ndryshme, të cilat jo vetëm për nga natyra, por edhe nga kompleksiteti, rritin shkallën e vështirësisë së gjykimit; (ii) së dyti, tek fakti se për shkak të vendimmarrjes së KPK-së, është bërë rishortimi i dosjeve të dy gjyqtarëve, duke rritur në mënyrë të menjëhershme ngarkesën e tij; (iii) së treti, tek numri i ulët i gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit Durrës. Referuar, shkaqeve në çështje të veçanta, gjyqtari ka identifikuar çështjet të cilat i kanë kaluar pas rishortimit si rezultat i vendimmarrjes së KPK-së apo heqjes dorë të gjyqtarëve të tjerë, çështjet në të cilat duke zbritur pushimet gjatë muajit gusht do të rezultonin të gjykuara në afat, si dhe çështjet të cilat kanë pasur në përbërje të tyre disa objekte gjykimesh.

Përfundimisht, duke bërë një analizë matematikore dhe logjike të të dhënave burimore, në cilësinë e relatores kam vlerësuar se në përcaktimin e nivelit të pikëzimit konsiderohen në rastin konkret, për gjyqtarin {...} duhet të vlerësohet:

i) ngarkesa e lartë e gjyqtarit si relator dhe anëtar (në total ai gjatë vitit 2021 ka gjykuar 395 çështje si relator dhe 761 çështje si anëtar);

ii) ngarkesa e shtuar e gjyqtarit për shkak të caktimit të tij për të gjykuar në gjykata të tjera të apelit, të ndryshme nga ajo në të cilin ai ushtron gjykimin, në total për 21 çështje;

iii) vetëvlerësimi i gjyqtarit lidhur me shkaqet objektive që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimeve;

iv) numrin e lartë i çështjeve me afat ligjor ku gjyqtari ka qenë relator pasi rezulton se ka përfunduar 158 çështje me afat ligjor, të cilat në tërësinë e tyre përbëjnë 40 % të çështjeve të shqyrtuara prej tij në vitin 2021;

v) tejkalimin e pragut të përqindjes që çon në pikëzim maksimal të këtij treguesi me vetëm 2 %.

Sa më sipër, vlerësoj se gjyqtari, pavarësisht të dhënave duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi se sa rezulton nga analiza e të dhënave statistikore sipas metodologjisë, konkretisht kam propozuar që të pikëzohet me 15 pikë.

Sa më sipër vlerësoj që gjyqtari për këtë tregues duhet të pikëzohet me 15 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara jashtë afatit ligjor është 12% por ndërkohë gjyqtari ka përfunduar një numër tepër të lartë çështjesh si relator, nga të cilat 40% ka qenë çështje me afat ligjor.

Për sa i përket "Plotësimit të standardit minimal kohor", duke referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të standardit minimal kohor (kanë qenë vetëm 16 çështje), me numrin total të çështjeve të gjykuara, pa përfshirë çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi (274 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar vetëm 6 % (më konkretisht 5.83 %) të çështjeve në tejkalim të standardit minimal kohor.

Për këto arsye, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standard

minimal kohor në gjykatën e apelit, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 6 %, rezulton që pavarësisht ngarkesës së lartë në punë, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdesin maksimal për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afateve të shkurtra (standardeve minimale dhe më të shkurtra se standardi minimal) dhe në 94 % të tyre e ka respektuar këtë standard. Për këtë arsye, sipas metodologjisë propozoj që pikëzimi për këtë tregues të jetë me 5 pikë.

Për sa i përket "Kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje", në tërësi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit si dhe krahasimit të kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje për të gjitha kategoritë, me standardin minimal kohor në fuqi për kategori çështjesh, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër se ky afat për të gjitha kategoritë e çështjeve. Pavarësisht volumit të çështjeve, specifikave të gjykimit në apel në lidhje me organizimin e punës për shkak se gjykimi zhvillohet me trup gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për zhvillimin e gjykimit brenda afateve të shkurtra, duke treguar shkallë shumë të lartë aftësie, prandaj edhe për këtë tregues është propozuar pikëzimi me 5 pikë.

Për sa i përket "Rendimentit të çështjeve", nga analiza e burimeve të vlerësimit të pasqyruar në raportin analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, si raport mes numrit të çështjeve të përfunduara si relator (395), me numrin total të çështjeve të caktuara brenda vitit kalendarik 2021 (537) është rreth 74 % (73,5 %), rendiment i cili sipas metodologjisë, pikëzohet me 2 pikë.

Në formularin e integruar të vlerësimit, gjyqtari ka shpjeguar se për shkak të vendimmarrjes së KPK-së, është bërë rishortimi i dosjeve të dy gjyqtarëve, duke i kaluar në cilësinë e relatorit, përkatësisht në muajin qershor 2021 një numër prej 105 çështjesh dhe në muajin tetor 2021 një numër prej 96 çështjesh. Ka qenë një ngarkesë e papritur e punës së gjyqtarit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues bëhet duke vlerësuar të dhënat që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Mbi këtë bazë, vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që

lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit. Kjo e fundit merret në konsideratë vetëm në rast se gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës, i përcaktuar në rastin konkret 175 çështje (është parasysh në këtë rast edhe kohëzgjatja e ushtrimit të funksionit si zëvendëskryetar nga ana e zotit {...}). Është parashikuar në projektraport edhe përmbajtja e aneksit përkatës të sistemit të vlerësimit.

Në rastin konkret gjyqtari kishte për një periudhë 3-mujore, brenda periudhës së vlerësimit, periudhë gjatë të cilës ai ka ushtruar njëkohësisht edhe funksionin drejtues në cilësinë e zëvendëskryetarit, çka nënkupton edhe një ngarkesë sasiore gjatë vitit prej jo më pak se 153.

Gjyqtari, nga ana tjetër, ka përfunduar në total 395 çështje si relator, nga të cilat 176 çështje janë me palë kundërshtare, pra e ka tejkaluar standardin minimal të ngarkesës vetëm me 23 çështje, ose 15 %.

Sa i përket shkaqeve të bëra prezent nga gjyqtari të cilat kanë ndikuar në rendimentin e përfundimit të çështjeve, rezulton se në gjashtëmujorin e dytë të vitit 2021, janë larguar nga detyra dy gjyqtarë të Gjykatës së Apelit Durrës, çka ka sjellë si pasojë rishortimin e çështjeve të tyre në muajt qershor dhe tetor 2021, duke shtuar numrin e çështjeve të caktuara gjyqtarit subjekt vlerësimi me 201 çështje. Nëse do të përllogarisim rendimentin e përfundimit të çështjeve referuar vetëm çështjeve të caktuara gjyqtarit {...}, duke zbritur nga numri total i çështjeve të caktuara (537), e cila ka rritur ngarkesën e menjëhershme të punës, atëherë rendimenti i përfundimit të çështjeve do të rezultonte në masën 90%.

Konkluzione: Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, veçanërisht: (i) të dhënave statistikore nga të cilat rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjatë gjithë vitit 2021, 395 çështje si relator, nga të cilat 176 çështje me palë kundërshtare, duke tejkaluar treguesin sasior vetëm me 15%; (ii) ngarkesës së tij si anëtar (761 çështje); (iii) numrit 21 të çështjeve të caktuara në gjykata të ndryshme nga ajo në të cilën gjyqtari ushtron funksionin (por referoj e në këto 21 çështje nuk ka pasur çështje si relator); (iv) rritjen e papritur të volumit të çështjeve për shkak të rishortimit të çështjeve të gjyqtarëve të larguar nga detyra (në total janë rishortuar 201 çështje ose rreth 37% të totalit të

çështjeve të caktuara gjatë vitit), kam vlerësuar se rendimenti i përfundimit të çështjeve nga gjyqtari, pavarësisht se duke iu hequr këto çështjet e shortuara në mënyrë të menjëhershme rezulton 90%, sipas metodologjisë do të pikëzohej me 6 pikë. Pavarësisht kësaj, vlerësoj që duhet të vlerësohet gjyqtari me një shkallë më të lartë pikëzimi, duke u pikëzuar me 8 pikë. Kjo pasi referuar Metodologjisë së Pikëzimit, shkaqet që kanë ndikuar në rendimentin e gjyqtarit lidhen me ngarkesën e punës gjatë vitit të vlerësimit përkatës edhe me çështjet e caktuara në gjykata të tjera dhe rritjen e papritur të volumit të çështjeve, ngarkesë e cila duket që nuk e ka penguar gjyqtarin të tejkalojë standardin sasior në fuqi. Por ky tejkalim nuk rezulton sipas metodologjisë mbi 50% të standardit sasior, pasi konstatohet se 219 çështje të shqyrtuara, janë kërkesa pa palë kundërshtare.

Përfundimisht, ky tregues vlerësoj se duhet të pikëzohet me 8 pikë, pasi edhe pse gjyqtari ka gjykuar një numër relativisht të lartë çështjes në cilësinë e relatorit dhe anëtarit, nuk rezulton të ketë tejkaluar standardin minimal sasior për çështjet me palë kundërshtare në masën 50% për të justifikuar një pikëzim maksimal.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari nuk ka paraqitur asnjë kundërshtim për sa i përket kundërshtimeve të paraqitura lidhur me projektraportin e vlerësimit. Kështu që, nuk është momenti për të bërë një arsyetim tjetër.

“Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” si një tregues tjetër. Nga analiza e të dhënave burimore, koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pavarësisht se rezulton më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve dhe përkon me 12 pikë sipas metodologjisë, kam vlerësuar se duhet të pikëzohet me një nivel më të lartë pikëzimi dhe konkretisht me 15 pikë, duke konsideruar si faktor që ka ndikuar në këtë tregues ngarkesën tepër të lartë në punë të gjyqtarit (janë relatuar tashmë prej meje shifrat), rritjen e papritur të volumit të çështjeve në periudhën e vlerësimit, angazhimin e tij në gjykimin e çështjeve të caktuara në gjykata të tjera të apelit, impenjimin në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, si dhe tejkalimin e kohës mesatare të arsyetimit maksimalisht me 12 ditë, afat që justifikon pikëzimin me një nivel më të lartë pikëzimi dhe konkretisht me 15 pikë.

Për sa i përket treguesit të “Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien

e seancave joproduktive”, nga burimet e vlerësimit ka rezultuar se numri i seancave gjyqësore me palë kundërshtare është vetëm 2 seanca dhe gjyqtari në çdo rast, referuar dosjeve të këqyrura, ka marrë masat e nevojshme për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet. Për këtë arsye, propozimi është me 15 pikë.

Për sa i përket treguesit të “Kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor”, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit të mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal, në seancat gjyqësore të zhvilluara. Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 20 pikë.

Për sa i përket “Rregullshmërisë së dokumentacionit të dosjes”, “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes”, për të dy këta tregues është propozuar shkallë shumë e lartë aftësie, përkatësisht me 5 dhe 10 pikë, për shkak se renditja e akteve të dosjeve, e cila përgjithësisht është e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që dosja të jetë lehtësisht e shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykatat më të larta. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi. Nuk rezulton mungesa e dokumentacionit në dosjet e vëzhguara apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Përfundimisht, për kriterin e dytë të “Aftësive organizative të gjyqtarit” propozohet niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm", pikët 98.

Për sa i përket “Etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale”.

Etika në punë, aspekti i parë. Treguesi “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion”. Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në raportin analitik, për periudhën janar 2021 - 31.12.2021, rezulton të jenë regjistruar dhe të jenë trajtuar nga ana e ILD-së 5 (pesë) ankesa, të cilat kanë përfunduar të gjitha me vendim arkivimi. Nuk është referuar asnjë prej tyre për vlerësim etik dhe profesional. Kryesisht ankesat janë arkivuar sepse është konkluduar që shkaqet e ngritura në këto ankesa lidhen me mënyrën e zgjidhjes së çështjes dhe të vlerësimit të provave, kompetencë e cila është ekskluzive

e gjykatës. Në këto 5 ankesa nuk evidentohen të dhëna që mund të afektojnë këtë aspekt të vlerësimit të gjyqtarit.

Nga ana tjetër, ankesat nuk rezultojnë të kenë evidentuar as elementë të cenimit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion të gjyqtarit.

Referuar të dhënave lidhur me rastet e pranimit të kërkesave të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, rezulton se në 6 raste kërkesat e palëve janë pranuar dhe gjyqtari është përjashtuar nga gjykimi për shkak se ka marrë pjesë në gjykimin e çështjeve të cilat kanë lidhje me çështjen në gjykim (të tilla si shqyrtimi i kërkesave të fazës së hetimit paraprak, gjykimin e çështjes në rastin e kthimit të saj për rigjykim, etj.). Në këto raste vendimi i përjashtimit konsiston në konstatimin e prezencës së shkaqeve të parashikuara nga neni 72, pika 471 e K.Pr.Civile ose neni 18, pika 1, shkronja a) në lidhje me 15, pika 1 dhe 2 të K.Pr.Penale. Në një rast shkaku i përjashtimit konsiston në prezencën e një tjetër shkaku dhe konkretisht të njohjes së tij me bashkëshortin e palës së paditur. Në një rast tjetër, kërkesa është pranuar por ndërkohë rezulton se gjyqtari ka paraqitur paraprakisht dorëheqjen, e cila nuk rezulton të jetë shqyrtuar nga kryetari i gjykatës dhe për pasojë, gjykimi për shqyrtimin e kërkesës për përjashtim ka vijuar duke përfunduar me vendim pranimi. Në Formularin e Integruar të Vlerësimit, në kuadër të shpjegimeve mbi treguesin "3.C.b Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit.", lidhur me këtë aspekt shpjegohet se: "Në lidhje me vendimet me të cilat janë pranuar kërkesat për përjashtim, sqaroj se, pjesa më e madhe e këtyre vendimeve i përkasin periudhës pas zgjedhjes sime si zëvendëskryetar i Gjykatës së Apelit Durrës më datë 28.09.2021, duke ushtruar njëkohësisht edhe funksionin e kryetarit në detyrë, dhe për shkak të shpejtësisë që impononin çështjet në gjykim edhe pse shkaku i përjashtimit edhe në vlerësimin tim ishte në kushte pranueshmërie, për të mundësuar gjykimin sa më të shpejtë të çështjes, i është bërë me dije palëve në proces shkaku për t'u iniciuar më pas procedura e përjashtimit.". Pra evidentohet që gjyqtari nuk ka paraqitur kërkesën për heqje dorë dhe pse ka qenë në dijeni të këtij shkaku.

Duke konsideruar shpjegimet e gjyqtarit dhe kohën e zgjedhjes së tij si zëvendëskryetar i gjykatës, rezulton se nga 7 kërkesa të pranuara për përjashtimin e gjyqtarit, pa përfshirë këtu rastin në të cilin rezultoi se ai ka dhënë dorëheqjen nga

gjykimi, por nuk ishte shqyrtuar nga kryetari, 2 prej tyre i përkasin periudhës në të cilën ai nuk ka ushtruar funksionin e drejtuesit të gjykatës dhe 5 të tjera i përkasin kësaj periudhe, pra kemi 5 kërkesa pas datës 28.09.2021 dhe 2 kërkesa para kësaj date. Në këto 7 raste, nga përmbajtja e vendimeve gjyqësore me të cilat është pranuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari të ketë dhënë dorëheqjen nga gjykimi i çështjes pavarësisht se shkaqet e ngritura përbëjnë shkak për heqjen dorë të gjyqtarit, referuar dispozitave përkatëse ligjore.

Duke konsideruar shpjegimet e gjyqtarit lidhur me qëllimin për të cilin ai nuk ka hequr dorë nga gjykimi i këtyre çështjeve për të mos ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve në raport me parashikimet ligjore procedurale që përcaktojnë rastet në të cilat gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi, si dhe mungesës së pasojave nga sjellja e tij, pasi nuk rezultojnë të dhëna që kjo sjellje të ketë vënë në rrezik parimin e paanshmërisë, duket sikur gjyqtari ka "shmangur" zbatimin e institutit procedural të "heqjes dorë nga gjykimi", në rastet kur janë prezent shkaqe që pengojnë pjesëmarrjen e tij në procedim. Duke aplikuar heqjen dorë nga gjykimi për rastet ku, sikurse vetë gjyqtari shpjegon, ka qenë i vetëdijshëm për prezencën e shkaqeve ligjore të zbatimit të këtij instituti, duket se gjyqtari nuk ka treguar kujdesin e duhur për të minimizuar rastet kur do të jetë i nevojshëm përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes.

Pavarësisht qëllimit të tij, i cili siç gjyqtari ka shpjeguar, është bërë në dobi të efiçencës së gjykimit të çështjeve (për 5 nga shtatë rastet e shqyrtuara), kjo sjellje duket se përmban elementë të cilët duhet të vlerësohen në kuadër të etikës, në angazhimin dhe përgjegjshmërinë në funksion të gjyqtarit. Duke iu referuar edhe Kodit të Etikës, në kapitullin II, seksioni B, pika 7, shkronja dh), parashikohet si një ndër elementët që lidhen me parimin e paanshmërisë, detyrimi i gjyqtarit që brenda kufijve të arsyeshëm, të veprojë në mënyrë të tillë që të minimizohen rastet ku do të jetë i nevojshëm përjashtimi i tij nga gjykimi i çështjes. Ky aspekt ka të bëjë me detyrimin e gjyqtarit për t'u sjellë në mënyrë të tillë që të mos bëhet shkak për të krijuar tek palët në proces asnjë përshtypje që mund të diktojë ngritjen e pretendimeve për përjashtimin e gjyqtarit. Është sjellja e gjyqtarit ajo që ka rëndësi në shmangien e perceptimit mbi anshmërinë e tij në gjykimin e një çështjeje. Në rastin konkret sjellja e gjyqtarit {...} nuk është e tillë që të ketë

ndikuar tek palët për të kërkuar përjashtimin e tij, por përbën një sjellje të karakterit formal, pasi shkaqet e mospjesëmarrjes së tij në gjykim kanë qenë prezente dhe të paktën në 6 nga 7 raste, gjyqtari është përjashtuar nga gjykimi për shkak të pengesave ligjore procedurale të tij për të marrë pjesë në gjykim. Vetëm në një rast shkaku i përjashtimit lidhet me njohjen e tij me palët, por ky rast i vetëm, duke konsideruar shpjegimet e tij se arsyeja e kësaj sjelljeje ka qenë për të mos shkaktuar vonesa në gjykimin e çështjeve, nuk mund të përbëjë shkak të mjaftueshëm për të konkluduar se ka cenuar shkallën e aftësisë së tij në drejtim të treguesit të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion. Nga përmbajtja e vendimeve të pranimit të kërkesës për përjashtim, në një rast bëhet fjalë për "lidhje miqësore", fakte të cilat gjyqtari rezulton t'i ketë bërë prezent për palët, madje përjashtimi është kërkuar nga vetë pala me të cilën është pranuar kjo lidhje. Relatimi dhe reklamimi i shkakut të përjashtimit për palët në gjykim, pavarësisht se gjyqtari nuk ka paraqitur kërkesë "për heqje dorë nga gjykimi", është tregues i reagimit të gjyqtarit për të shmangur perceptimin objektiv tek palët të dukjes si i anshëm, sjellje kjo që nuk duhet të afektojë negativisht etikën në punë të gjyqtarit. Ndërsa në vendimet e tjera të përjashtimit që i referohen papajtueshmërisë për pjesëmarrje në procedim, apo të dhënies së mendimit për faktet objekt gjykimi, duket që instituti i "heqjes dorë" nuk është përdorur vetëm në aspektin formal, pasi gjyqtari duke pranuar edhe vetë në formularin e vlerësimit që shkaku i përjashtimit ka qëndruar, ka vlerësuar me përparësi duke i dhënë rëndësi shqyrtimit pa vonesa të çështjes dhe jo llojit të instrumentit që duhej të përdorej për t'u përjashtuar. Theksoj këtu që, duke qenë që ka pasur funksionin e zëvendëskryetarit, dorëheqja duhej të shqyrtohej nga kryetari i Gjykatës së Lartë. Gjithsesi kjo është një çështje që mbetet për t'u shqyrtuar nga Këshilli.

Në tërësi, në cilësinë e relatores, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk ka shfaqur sjellje që mund të cenojnë etikën e tij në punë. Për këto arsye, për këtë tregues, kam vlerësuar që gjyqtari duhet të vlerësohet me shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion, duke u pikëzuar me 35 pikë.

Për sa i përket "Integritetit", "Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti", duke iu referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së

Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të cenojnë integritetin (dhe këtu janë marrë të dhëna lidhur me masat disiplinore që nuk ka, me të dhënat e verifikimit të ankimeve, është marrë në konsideratë edhe raporti i ILDKPI-së) kam vlerësuar që gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtarit. Për këtë arsye propozohet pikëzimi me 40 pikë.

Për sa i përket "Paanësisë së gjyqtarit", "Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese", nga analiza e të dhënave burimore, ka rezultuar se në asnjë rast nuk është përdorur gjuhë diskriminuese në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara. Për këto arsye, kam propozuar pikëzimin me 10 pikë.

Për sa i përket "Numrit tejet të lartë të kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit", janë paraqitur 15 kërkesa për përjashtim, nga të cilat 9 janë pranuar duke u bazuar në nenet 72, pika 4 dhe 6 të K.Pr.Civile dhe 15, pika 1 të K.Pr.Penale. Për sa i përket përmbajtjeve dhe efekteve të këtyre vendimeve të përjashtimit, ato u morën parasysh tek kriteri paraardhës i angazhimit dhe i përgjegjshmërisë në funksion. Ndërkohë, gjyqtari ka paraqitur 39 kërkesa për heqje dorë, nga të cilat 35 janë pranuar.

Sa më sipër, rezulton se numri i kërkesave të pranuara për përjashtimin e gjyqtarit është 7 (shtatë), nga të cilat 6 (gjashtë) lidhen me shkaqe procedurale të cilat pengojnë pjesëmarrjen ne gjykim (duke qenë se gjyqtari ka shqyrtuar çështje të cilat lidhen me ato objekt shqyrtimi) dhe 1 (një) lidhet me ekzistencën e njohjes së tij me palët, rast në të cilin vetë gjyqtari ka konfirmuar dhe ka shprehur dakordësinë për t'u përjashtuar nga gjykimi i çështjes. Madje ka rezultuar që shkaku i përjashtimit është reklamuar nga vetë gjyqtari.

Sipas Metodologjisë së Pikëzimit, për të vlerësuar nëse numri i kërkesave të palëve për përjashtim të gjyqtarit është "tejet i lartë", vlerësuesi rast pas rasti nuk përqendrohet vetëm në numrin e vendimeve të pranuara për përjashtimin, por analizon edhe tregues të tjerë të dalë nga burimet e vlerësimit, e mbi të gjitha sjelljen e gjyqtarit ndaj reklamimit të shkakut të përjashtimit. Gjyqtari duhet të heqë dorë nga pjesëmarrja

në procedura në të cilat ai në fakt nuk është në gjendje të vendosë çështjen në mënyrë të paanshme, apo në procedura në të cilat nuk mund të duket një personi të arsyeshëm që gjyqtari nuk mund të jetë i paanshëm. Ajo që ka rëndësi është sjellja e gjyqtarit ndaj të dukurit i paanshëm.

Në referim të parimit kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, duke mbajtur në konsideratë të dhënat burimore për numrin e kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, shkaqet për të cilat është vendosur përjashtimi dhe sjelljen e gjyqtarit ndaj shkakut të përjashtimit, numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtim duhet të vlerësohet i pakonsiderueshëm.

Arrihet në këtë konkluzion duke vlerësuar se (i) shkaqet e përjashtimit të gjyqtarit në 6 nga 7 kërkesat e pranuara lidhen me shkaqe procedurale; (ii) në rastin e konfliktit të interesit kërkesa për përjashtim është iniciuar pasi gjyqtari e ka reklamuar vetë shkakun e përjashtimit; (iii) numri i kërkesave të pranuara në raport me numrin e çështjeve të shqyrtuara përbën një numër të papërfillshëm.

Pavarësisht numrit të kërkesave të pranuara për përjashtimin e gjyqtarit i cili në kuptim të këtij treguesi vlerësohet i papërfillshëm dhe nuk rezultojnë shkaqe të cilat mund të vlerësohen në drejtim të paanësisë së gjyqtarit dhe posaçërisht dy treguesve të këtij aspekti, të dhënat që rezultojnë lidhur me sjelljen e gjyqtarit në raport me rastet në të cilat ai është përjashtuar nga gjykimi, ndërkohë që ka pasur pengesë për të marrë pjesë në gjykimin e një çështjeje, referuar parashikimeve të ligjit procedural, janë konsideruar dhe u analizuan paraprakisht prej meje aspektin “3.A.a Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.”

Për këtë arsye, duke vlerësuar numrin e kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit të pakonsiderueshme, kam propozuar pikëzimin me 15 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e tretë “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”, niveli i vlerësimit propozohet "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket kriterit të fundit “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”, propozohet pikëzimi maksimal për “Komunikimin e qartë dhe transparent”, “Aftësinë për të bashkëpunuar”, “Shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën

gjyqësore". Nga të dhënat burimore ka rezultuar se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit, bashkëpunimit me kolegët dhe administratën gjyqësore.

Ndërkohë, për sa i përket aspektit të fundit të këtij kriteri, "Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera", treguesit "Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale", ka rezultuar se përgjatë vitit kalendarik 2021, gjyqtari {...} ka marrë pjesë në cilësinë e pjesëmarrësit vetëm në aktivitetin trajnues të datës 17 dhjetor 2021, në të dy sesionet e tij, konvertuar në numër ditësh, përkatësisht 1 ditë. Ndërkohë, ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i ndryshuar, në pikën 3 të nenit 5 të tij ka parashikuar se periudha e formimit vazhdues duhet të jetë jo më pak se pesë ditë të plota dhe jo më shumë se 40 ditë të plota, në vit. Rrjedhimisht, sipas Metodologjisë së Pikëzimit, e cila përcakton se gjyqtari që ka marrë pjesë në më pak se 15 ditë të plota ose më shumë se 120 ditë plota përgjatë periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, ose më pak se 30 ditë plota ose më shumë se 200 ditë të plota përgjatë periudhës 5-vjeçare të vlerësimit vlerësohet me 4 pikë, në mënyrë proporcionale konkludohet se gjyqtari në periudhën 1-vjeçare të vlerësimit, duhet të kishte marrë pjesë minimalisht në aktivitete trajnuese për një kohëzgjatje prej 5 ditësh.

Për këtë arsye, në kushtet kur gjyqtari ka marrë pjesë vetëm në një aktivitet trajnues, i cili ka zgjatur 1 ditë, gjatë gjithë periudhës 1-vjeçare të vlerësimit, ai sipas metodologjisë duhet të pikëzohet me 4 pikë, pasi nuk rezulton të ketë marrë pjesë minimalisht për 5 ditë trajnimi, sipas parashikimeve të ligjit, prandaj dhe është bërë pikëzimi me 4 pikë.

Për të mos iu rikthyer edhe një herë këtij treguesi.

Gjyqtari ka paraqitur kundërshtime lidhur me pikëzimin e këtij treguesi. Këto kundërshtime janë vënë në dispozicion anëtarëve. Unë po i them në mënyrë të përmbledhur arsyet për të cilat gjyqtari e kundërshton pikëzimin sipas këtij treguesi.

Citoj nga kundërshtimet e gjyqtarit:

"... Objeksioni im konsiston në atë nëse është i drejtë dhe i përligjur penalizimi i magjistratit në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të përshpejtuar të detyruar, për

shkak të mospërmbushjes në masën e duhur, për arsye objektive dhe të ligjshme, të detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues përgjatë një viti kalendarik.

Këtë objeksion e shtroj nisur nga fakti se ky vlerësim është një nga dy vlerësimet që shërbejnë si kriter renditjeje dhe përparësie në kuadër të procedurës së ngritjes në detyrë të magjistratit, çka do të thotë se një penalizim i tillë ka efekt jo vetëm në vlerësimin etik dhe profesional të magjistratit, por edhe për sa i përket së drejtës për karrierë të tij.

Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk përmban rregullime mbi të cilat mund të konsiderohet e justifikueshme, jo penalizuese në vlerësimin etik dhe profesional të magjistratit, mospërmbushja në masën e duhur e detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues përgjatë një viti kalendarik. Edhe metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit nuk përmban rregullime në këtë drejtim.

Mendoj se në karrierën e magjistratit, periudha e njëvjeçare e vlerësimit është e vogël dhe mund të thuhet e papërfillshme. Nga ana tjetër, vlerësimi etik dhe profesional i përshpejtuar i detyruar është një instrument ligjor i zbatueshëm për një periudhë të përkohshme/kalimtare që përfshin vitin e fundit kalendarik. Si rregull, referuar ligjit për statusin, magjistratët vlerësohen për periudha 3 ose 5-vjeçare, ku për sa i përket vlerësimit për nëntreguesin "Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale", ligji vendos një numër tavan ditësh trajnimi për periudhën përkatëse të vlerësimit, çka do të thotë se magjistrati mund të rikuperojë numrin e nevojshëm të trajnimeve brenda viteve pasardhës. Për vlerësimin etik dhe profesional të detyruar magjistrati nuk e ka këtë mundësi.

Ndaj, mendoj se nuk do të ishte e përligjur dhe proporcionale penalizimi i magjistratit për zhvillimin e karrierës për shkak të penalizimit të tij në vlerësimin etik profesional të përshpejtuar të detyruar pikërisht për mospërmbushjen në masën e duhur të detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues përgjatë një viti kalendarik, kur ajo ka ndodhur për arsye objektive dhe të ligjshme.

Thënë këtë, kam parasysh kohëzgjatjen e shkurtër të periudhës minimale të ndjekjes së detyrueshme të programit të formimit vazhdues (5 ditë), në raport me pikëzimin respektiv sipas metodologjisë (20 pikë), sikundër edhe ndikimin që pikëzimi

i këtij nëntreguesi ka në rezultatin e vlerësimit tërësor të kriterit të "Aftësive profesionale dhe angazhimit profesional". Referuar metodologjisë së pikëzimit, pikëzimi i këtij nëntreguesi është përcaktues në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë kriter, nivel ky që, nga ana tjetër, është përcaktues për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit për periudhën përkatëse.

Në vlerësimin tim, parësore për gjyqtarin është përmbushja e detyrave gjyqësore, çka nuk nënkupton mospërmbushjen e detyrimeve të tjera ligjore, përfshirë dhe atë të ndjekjes së programit të formimit vazhdues, detyrim ky, qëllimi i të cilit shkon në funksion të përmbushjes më së miri të detyrave gjyqësore.

Për sa më sipër, objeksioni im është mospenalizimi në atë masë sa i përket vlerësimit të nëntreguesit të "Pjesëmarrjes së gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale", për arsye se mospërmbushja në masën e duhur të detyrimit për ndjekjen e formimit vazhdues ose trajnimeve të tjera profesionale gjatë vitit 2021 ka ndodhur për shkaqe objektive dhe të ligjshme."

Pastaj gjyqtari ka cituar arsyet për të cilat ai nuk i ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar minimumi 5 ditë në vit, që lidhet me angazhimin e tij në detyrën e trupës gjyqësore në Gjykatën e Apelit Durrës; numrin e vogël të gjyqtarëve, angazhimin e tij për të gjykuar në gjykata të tjera; angazhimin për sa i përket përgjegjësisë së menaxhimit të gjykatës dhe njëkohësisht edhe angazhimin që ka pasur në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar.

Në përfundim gjyqtari vlerëson që kanë qenë pikërisht këto shkaqet që e kanë penguar objektivisht të përmbushë në masën e duhur detyrimin për ndjekjen e programit të formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës ose në trajnime të tjera profesionale. Prandaj ka kërkuar që të pikëzohet me pikëzimin maksimal për këtë tregues.

Në vlerësimin tim si relatore, konkluzionet ose objeksionet e gjyqtarit nuk lidhen me moszbatimin e ligjit apo me moszbatimin e metodologjisë por në fakt janë shkaqe të cilat mund të merren parasysh në kuadrin e fillimit ose jo të një procedimi disiplinor.

Ligji e ka të parashikuar në mënyrë të qartë që gjyqtari e ka detyrim ligjor që të bëjë jo më pak se 5 ditë trajnimi në vit. Pra duhet t'i ketë 5 ditë. Në të kundërt, nëse

nuk respektohet ky detyrim ligjor i gjyqtarit, kjo sipas dispozitave të shkeljeve disiplinore në detyrë, përbën shkak për fillimin e një procedimi disiplinor për gjyqtarin. Pra nuk është konstatim i drejtë ai që gjyqtari parashikon që nuk ka penalizim në ligj për sa i përket mosplotësimit të detyrimit për trajnimit. Por ligji parashikon që kushtet e një fillimi të një procedimi disiplinor është i kondicionuar nga ekzistenca e rrethanave të paarsyeshme dhe jo objektive për mosplotësimin e detyrimit. Në kushtet kur ka shkaqe objektive dhe të arsyeshme si ato që gjyqtari relaton në kundërshtimet e tij për mosplotësim të detyrimit ligjor, atëherë këto janë rrethana që merren parasysh vetëm në rastin e një procedimi disiplinor. Në rastin e vlerësimit etik dhe profesional, në Metodologjinë e Pikëzimit dhe në ligj, nuk kanë rëndësi shkaqet për të cilat gjyqtari nuk e zbaton detyrimin ligjor. Pra metodologjia përcakton që (është i vetmi rast ndoshta kur ne nuk kemi diskrecion për të vendosur ndryshe) 4 pikë, në rastet kur gjyqtari nuk plotëson detyrimin ligjor ose edhe në rastet kur tejkalon ditët që janë parashikuar në ligj dhe 20 pikë në rastet kur gjyqtari e respekton detyrimin ligjor pa bërë diferenca për gjyqtarët që bëjnë 5 apo për gjyqtarët që bëjnë 20. Kjo është bërë për shkak sepse pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e trajnimit vazhdues është detyrim ligjor (nuk është fakultative) dhe e dyta, duhet të nxiten gjyqtarët për t'u trajnuar në mënyrë të vazhdueshme. Kjo gjë duket që ka afektuar me rritjen e numrit të trajnimeve në Shkollën e Magjistraturës. Nga ana tjetër, ne deri tani kemi vlerësuar me të njëjtën mënyrë pikëzimi disa gjyqtarë për mosrespektimin e ditëve dhe kohës së nevojshme për pjesëmarrjen në programin e trajnimit vazhdues. Ka pasur disa gjyqtarë që kanë pasur 1, 2 apo ndoshta edhe 4.5 ditë dhe përsëri nuk janë pikëzuar me 20 pikë.

Pavarësisht se shpjegimet dhe shkaqet e parashtruara nga gjyqtari qëndrojnë, vërtetë ai ka pasur një ngarkesë, vlerësoj se mosrespektimi i 5 ditëve (janë vetëm 5 ditë trajnimi vazhdues) në rastin konkret, duhet të ekuivalentohet në atë pikëzim që parashikon metodologjia, në 4 pikë. Pra nuk ka shkak për të rritur apo për ta çuar këtë pikëzim në 20 pikë.

(A kemi mbajtur qëndrim? – dikush nga anëtarët pa mikrofon)

Është një qëndrim i mbajtur, është rasti i zotit Lara, është rasti i zonjës Çeka, është

rasti i zotit Përdeda. Është një qëndrim që ne kemi mbajtur dhe është edhe në metodologji.

Për sa i përket treguesit tjetër "Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve", nuk ka pasur të dhëna që provojnë angazhimin e gjyqtarëve në këtë lloj veprimtarie. Për këtë arsye kam propozuar pikëzimin me 3 pikë.

Për sa i përket "Pjesëmarrjes së gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë", nga të dhënat e dosjes së vlerësimit dhe nga të dhënat që i bashkëngjiteshin formularit të vlerësimit ku gjyqtari mund t'i bashkëngjiste çdo akt që tregonin ngritjen e tij profesionale, nuk ka pasur të dhëna për
Kontribut të gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi. Për këtë arsye është pikëzuar me 3 pikë.

Edhe për këtë tregues gjyqtari ka paraqitur kundërshtimet e tij, ku ka parashtruar se:

"... Pavarësisht angazhimit të lartë në përmbushjen e detyrave gjyqësore, me dëshirën për të kontribuar në përmirësimin e sistemit të drejtësisë, në fakt kam marrë pjesë në një veprimtari që mendoj se duhet të konsiderohet si ndërinstitucionale në kuptim të metodologjisë së pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit.

Konkretisht, në datën 20 tetor 2021, me ftesë të Misionit EURALIUS V, kam marrë pjesë në aktivitetin me temë 'Rritja e efiçencës në gjykatat e apelit', që është zhvilluar në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nga Misioni EURALIUS V në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor ku të pranishëm kanë qenë anëtarë të Këshillit, përfaqësues nga misioni dhe disa gjyqtarë të gjykatave të apelit."

Për të provuar këtë, na ka bashkëngjitur një e-mail që i është dërguar gjyqtarit në adresën e tij elektronike, duke e ftuar të marrë pjesë në një takim në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, me temë "Rritja e efiçencës në gjykatat e apelit" dhe kërkon që edhe për këtë tregues të pikëzohet me 2 pikë të tjera, pra nga 3 të vlerësohet 5.

Në vlerësimin tim, referuar përmbajtjes së metodologjisë dhe ligjit, thjesht pjesëmarrja në aktivitete të tjera nuk përbën veprimtari ndërinstitucionale. Veprimtari ndërinstitucionale janë ato që provojnë kontribut relevant të gjyqtarit për përmirësimin

e sistemit. Mund të organizojmë shumë trajnime me gjyqtarët, mund të ftohen në shumë trajnime gjyqtarët, ato nuk vlerësohen në drejtim të këtij treguesi. Për këtë arsye vlerësoj që nuk është rasti për të rritur nivelin e pikëzimit nga 3 në 5 pikë.

Ndërkohë, për sa i përket "Publikimeve ligjore akademike", nuk kanë rezultuar të dhëna lidhur me këtë tregues në realizimin e ndonjë botimi. Propozohet pikëzimi me 0 pikë.

Përfundimisht, për kriterin e katërt që është "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional" propozohet niveli i vlerësimit "Shumë mirë", pikëzimi 75 pikë.

Përfundimisht, propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter vlerësimi dhe nivelin e përgjithshëm të vlerësimit është si më poshtë:

1. Aftësitë profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

2. Aftësitë organizative, 98 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 75 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Përfundimisht niveli i vlerësimit "Shumë mirë", pikët 373.

Në përfundim të tij, projektraporti përmban edhe disa rekomandime për gjyqtarin {...}, që është një detyrim ligjor që ne duhet ta parashikojmë, ku rekomandohet të vijojë dhe të marrë në konsideratë plotësimin e detyrimit ligjor për angazhimin e tij në programin e trajnimit vazhdues dhe në aktivitete të tjera për trajnimin e gjyqtarëve, në cilësinë e pjesëmarrësit, lektorit, apo pjesëmarrjen në veprimtari ndërinstitucionale si dhe në fushën e publikimeve ligjore dhe akademike, me qëllim ndarjen e përvojës profesionale dhe dhënien e kontributit për përmirësimin e sistemit gjyqësor.

Ju faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit zonja Ukperaj!

Atëherë, ftoj kolegët nëse kanë ndonjë diskutim.

Po, zoti Hallunaj!

Dritan Hallunaj: Faleminderit Kryetare!

Atëherë, duke parë raportin e paraqitur, unë desha të ndalem dhe të shtroj një diskutim këtu për sa i përket pjesës së shumë diskutuar, por jo të mbajtjes gjithmonë të një standardi (se keni pas edhe standarde të tjera, përveç atyre që u përmendën këtu; ka qenë edhe standardi i gjykatave të krimeve të rënda) për pjesën e pjesëmarrjes së gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera.

Po, - është e vërtetë problematika e hasur me anashkalimin që i kanë bërë gjyqtarët pjesëmarrjes në këtë shkollë, pjesëmarrjes në trajnime. Është e vërtetë që ka nevojë dhe duhet që trajnimi vazhdues të fuqizohet, forcohet, të modifikohet, dhe nga shkolla janë ndërmarrë hapa, por duhet të kemi parasysh që të gjitha këto janë bërë për efekt të kushteve të një situate optimale apo në kushtet e një situate normale, kur gjykatat kanë qenë plot me gjyqtarë (pra pa mungesa).

Çfarë ndodh sot? Ne na ndodh sot që gjyqtarët angazhohen shumë më tepër, pra i ke gjithë javën në Shkollën e Magjistraturës (ditë të hënë dhe ditë të premte nuk ke asnjë gjyqtar në gjykatat e rretheve, se të gjithë e kanë të prerë që "jemi tek Shkolla e Magjistraturës") dhe duke lënë detyrën kryesore që kanë, gjykimin.

Gjyqtari në fjalë është një gjyqtar me karrierë mbresëlënëse, me një vjetërsi, unë e kam lakmi për vete. Një gjyqtar i tillë që vjen në Shkollën e Magjistraturës, duhet të lerë punën atje, duhet të lërë gjyqet që janë planifikuar nga ai apo anëtarët e trupës gjykuese , dhe vjen këtu dhe merr pjesë në një trajnim që lektor jam unë që kam shumë më pak vjetërsi në punë se ai.

Përveç kësaj, problematika e madhe është edhe që, duhet të kemi parasysh që në periudhën në fjalë, gjyqtari ka qenë përpara Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Në qershor Komisioni (KPK-ja) ka dalë me vendim. Dimë presionin që ekziston apo ngarkesën që ka ai proces dhe dokumentacioni që duhet të jetë i gatshëm në kohën e përcaktuar nga organi kompetent.

Përveç kësaj, dimë problematikat që kanë ndodhur në atë gjykatë për shkak po të procesit të vetingut, ku është dashur që të largohen gjyqtarë; është dashur që të merren masa të ndryshohen trupa gjykues; është dashur që në disa vende ku dosjet i ka pasur një

gjyqtare që është larguar dhe menjëherë, në mënyrë të menjëhershme është dashur që të futet një gjyqtar tjetër.

Problematika që ai shtron, që thotë që "unë në atë periudhë kam drejtuar edhe gjykatën", nuk është e pavend, nuk është se nuk duhet marrë parasysh, pra që ka drejtuar një gjykatë dhe nuk ka marrë pjesë në 5 seminare të trajnimit të Shkollës së Magjistraturës; si dhe duhet të kemi parasysh edhe lëvizjen që është bërë me këto gjyqtarë për sa i përket delegimeve për gjykimin e çështjeve konkrete, ku e kanë filluar ditën në Gjykatën e Apelit Durrës, e kanë vijuar në një gjykatë apeli tjetër (në Tiranë), duke e mbyllur ndoshta edhe në Gjykatën e Apelit Vlorë.

Të gjitha këto elementë, ne mendoj që ne duhet t'i kemi parasysh kur bëjmë vlerësimin e gjyqtarit për këtë pikë, për pjesën e pjesëmarrjes së tij në seminare, trajnime, apo për pasojat që vijnë nëse nuk merr pjesë në këto seminare.

Pra këtë e shtroj si diskutim për të gjithë anëtarët, që të vlerësojmë me objektivitet. Ndoshta unë nuk jam që "hajde të flasim për pikët". S'flas fare për pikët. Por duhet të merren parasysh edhe këto. Se nuk mund t'i anashkalojmë të gjitha këto. Prandaj e shtroj për të gjithë ju dhe pastaj nëse nuk ka gjë, mund të bëj unë një propozim për sa i përket kësaj pike. Faleminderit!

Naureda Llagami: Po Ridvan!

Ridvan Hado: Edhe unë jam dakord me kolegun, për kriterin e katërt "Aftësitë personale dhe angazhimi profesional", për nënpikën që sapo citoi kolegu, nënpikën "C.a. Pjesëmarrjen në programin e formimit vazhdues". Është e vërtetë që ligji të detyron pjesëmarrjen 5 ditë në trajnimin e formimit vazhdues, por nga ana tjetër ne s'mund të rrimë pa marrë parasysh që gjyqtari që vlerësohet ka qenë në kushtet objektive të mospjesëmarrjes. Duke marrë parasysh faktin që ka pas ngarkesë të lartë, duke marrë parasysh faktin tjetër që trupa gjyqësore s'ka qenë e plotë, duke marrë parasysh faktin që ka qenë titullar, si dhe ka qenë në procesin e vetingut, këto çojnë në atë... se ne s'jemi thjesht që të bëjmë aritmetikë. Është e vërtetë që nga 5 ditë që duhet të merrte pjesë, ka marrë vetëm në 1 ditë, dhe i bie nga 20 pikë maksimale, pjesëtim për 5, i bie 4 pikë.

Unë mendoj që, prandaj jemi Këshilli i Lartë Gjyqësor, që t'i marrim parasysh këto dhe të bëjmë një vlerësim normal. Kjo ishte.

Nëse doni edhe propozim, mund të bëj.

Mendoj që mos të vlerësojmë për mospjesëmarrjen me 20 pikë, me një fjalë, me maksimalen sa pretendon ai, por ta vlerësojmë me 16 pikë. Ky të jetë një marzh. Ky është mendimi im. Faleminderit!

Brikena Ukperaj: Atëherë, ligji e parashikon pjesëmarrjen e gjyqtarit në veprimtaritë trajnuese në Shkollën e Magjistraturës si një nga treguesit apo indikatorët e vlerësimit. Kur ndërtuam Metodologjinë e Pikëzimit, për kriterin e katërt kemi diskutuar po ne të gjithë bashkë këtu, peshën që duhet t'i jepej secilit indikator, dhe kur them për peshën, ajo përkthehet në pikë. Pra do të kishte më shumë pikë ai kriter që kishte më shumë rëndësi. Dhe ne e dimë shumë mirë që, në botë, trajnimi vazhdues i gjyqtarëve, vlerësohet shumë herë më shumë sesa vlerësimi i gjyqtarëve. Pra gjyqtarët janë të detyruar të ndjekin trajnimet vazhduese. Ne kemi ndjekur sistemin ligjor, të tillë që, ta bëjmë trajnimin të detyrueshëm dhe duke qenë se ligji e detyronte që të paktën 5 ditë në vit ti duhet të shkosh, pavarësisht ngarkesës që ke, se janë vetëm 5 ditë. Pavarësisht, ka pasur edhe kryetarë që kanë pasur këtë ngarkesë, ti e ke detyrim ligjor që duhet ta respektosh.

Jam dakord që të gjitha këto objeksione që thotë gjyqtari ekzistojnë, pa dyshim. Por ne jemi të detyruar që të zbatojmë metodologjinë dhe nuk mund të ndryshojmë rregulla loje në mes të vlerësimeve kur kemi disa gjyqtarë që i kemi vlerësuar po me 4 pikë, madje që kanë pasur edhe më shumë ditë se zoti {...}. 4.5 ditë mbaj mend zonjën Çeka, vetëm për 0.5 nuk arriti që të merrte 20 pikë.

Lidhur me atë që thotë zoti Hallunaj, që ne kemi standarde të ndryshme, në fakt kjo nuk është e vërtetë, dhe nëse zoti Hallunaj mendon që në këtë rast ne kemi zbatuar standarde të ndryshme, mund t'i citojë. Sepse ne kemi ndjekur dy vlerësime, i) vlerësimin e vitit të fundit kalendarik, ii) kemi bërë dhe vlerësimin e gradimit. Ç'kemi bërë në gradim? Për gjyqtarët në gradim, që ishte periudha e vlerësimit 2013-2016, ligji nuk ka qenë në fuqi dhe ligji i Shkollës së Magjistraturës, që e vendoste të detyrueshëm

trajnimin, nuk parashikonte ditët minimale, por parashikonte ditët maksimale, dhe për të mos penalizuar këta gjyqtarë, kemi thënë që pavarësisht bëre dy, bëre tre, bëre katër, pikët do t'i marrësh 20. Këtë qëndrim kemi mbajtur. Por për të gjithë gjyqtarët që janë vlerësuar pas hyrjes në fuqi të ligjit për statusin, në procedurë të përshpejtuar të vitit 2021 apo në procedurë trevjeçare vlerësimi, ne kemi zbatuar të njëjtin standard. Në këtë rast nuk kemi diskrecion.

Nëse doni apo anëtarët mendojnë, që pikërisht tani duhet të ndryshojë Metodologjia e Pikëzimit dhe për këtë kriter Këshilli mund të vendosë 4, 5, 16, 17 apo 18, ky është një diskutim tjetër pastaj që nuk i takon kësaj mbledhjeje, por duhet të rishikohet metodologjia. Në qoftë se vetë ne që e zbatojmë metodologjinë, që e kemi miratuar, nuk do ta zbatojmë, unë nuk di çfarë të them tani.

Naureda Llagami: Po, zoti Hallunaj!

Propozim konkret?

Dritan Hallunaj: Faleminderit!

Atëherë, për sa i përket asaj që thashë më lart, unë vazhdoj të insistoj tek pjesa... Thashë, kur hapim një diskutim, që hajde ta shohim në mënyrë se si të funksionojë dhe ta bëjmë sa më funksionale dhe të jemi sa më real me vlerësimin që ne do bëjmë për gjyqtarin. Pasi, nëse ju si komision keni ndonjë informacion apo të dhënë që gjyqtari, ditën që ka pasur për të ardhur tek Shkolla e Magjistraturës, s'ka qenë as në punë fare, jam shumë i hapur dhe jam koshient që nuk duhet, jo ta miratojmë, por të vazhdojmë edhe me atë pjesën tjetër, ndoshta edhe me fillimin e një procedimi disiplinor. Por nëse gjyqtari ka qenë në punë, nëse gjyqtari ka qenë i angazhuar në trupa gjykues. Më ka ndodhur mua personalisht kur kam gjykuar tek Gjykata e Krimeve të Rënda. E kisha planifikuar ditën për të vajtur atje, dhe kolegët më kanë thënë jo, se kemi planifikuar një seancë që jemi keq po themi me masat e paraburgimit. Dhe jam detyruar për ta anuluar këtë, për të qëndruar për të mirën e punës, për atë që kemi parësore. Kështu që them, hajde ta shohim me syrin... Asnjëherë nuk kam thënë këtu që hajde të japim vlerësimin maksimal me 20 pikë, as me 16. Nuk diskutova pikët. Diskutova vetëm pjesën që hajde

të shohim ndonjë mundësi për gjyqtarë të këtij niveli (të këtij kalibri), të cilët janë duke bërë punën, janë atje në salla gjyqi, janë duke udhëtuar në të gjithë territorin e Shqipërisë, për të gjykuar çështje, dhe për shkak se nuk kanë marrë pjesë në trajnim për shkak pune... Thashë nëse keni ndonjë indicie, keni një të dhënë që ky gjyqtar, ditën që ka pasur për t'u paraqitur për të ardhur në trajnim vazhdues, nuk ka qenë në punë apo nuk figuron të ketë qenë në seancë gjyqësore, jam plotësisht dakord dhe tërhiqem nga kjo. Por duhet ta vlerësojmë punën e gjyqtarit. Ai rropatet gjithë ditën atje. Vrapon nga një gjykatë në tjetrën. Drejton gjykatën me një numër të kufizuar gjyqtarësh dhe ne i themi thani "hajde merr pjesë edhe këtu".

Siç thashë, ke shumë gjyqtarë, dhe jo pak, që vijnë, dhe gjykatat e rretheve zakonisht ditë të hënë dhe të premte "nuk jam në punë, pasi jam në trajnim". Ato duhet të verifikojmë ne. Faleminderit!

Për pikët hajde diskutojmë. Nuk kam thënë në asnjë moment as 16, as maksimalen (as 20). Hajde diskutojmë. Por thjesht e hapa si problematikë.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Në fakt, me të drejtë zoti Hallunaj, ju e keni shprehur edhe herë tjetër në fakt dhe ndoshta, tashmë, duke parë metodologjinë, pse jo, edhe mund të reflektojmë për disa çështje kur flasim me realitetin. Sepse e ka ngritur zoti Hallunaj edhe në një vlerësim tjetër, që ndoshta edhe këto pikët edhe këto pjesëmarrje varen edhe nga ngarkesa e gjykatës. Ndoshta me hartën mund të kemi ndonjë shpresë që do kemi një shpërndarje më të drejtë të ngarkesës në gjykata.

Marçela Shehu: Në fakt edhe unë mendoj që metodologjia duhet parë, sidomos për këtë pjesë, sepse 20 pikë për trajnimin vazhdues, në këtë situatë në të cilën ndodhet sistemi, është situatë jo normale.

Naureda Llagami: Nga ana tjetër jam dakord me Brikenën. Kemi vlerësuar 100 veta deri më sot me këtë lloj metodologjie dhe s'mund të ndryshojmë. Duhet të vijë një moment që ne të marrim një grup pune, ta rishikojë metodologjinë, ta shohim për

çështje që ju me të vërtetë i ngrini siç është realiteti jonë dhe më pas pastaj të fillojmë vlerësimet. Por tashmë jemi pak..

Marçela Shehu: Nuk e di nëse kemi ndonjë rast që kemi cenuar, domethënë që është mbajtur 2 qëndrime. Tani edhe nuk na kujtohet çfarë ka ndodhur.

Naureda Llagami: Atëherë, kemi propozim konkret, përveçse diskutimit mbi metodologjinë që ndoshta duke parë ngarkesën e gjyqtarëve dhe gjithë dinamikat që ka sistemi, ndoshta është koha pse jo, ta rishikojmë metodologjinë në qasje më afër sistemit, për çështje që ne mendojmë që me të vërtetë mund të ketë vlerësim ose hapësirë për ta rivlerësuar. Përveç kësaj çështjeje, pikë konkrete ose propozim konkret?

Ridvan Hado: Unë e bëra propozimin.

Të vlerësohet për nënkriterin e pikës 4 "Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës", nga 4 pikë në 16 pikë.

(Hidhet në votim.)

Ilir Rusi: Kundër propozimit.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Kundër.

Marçela Shehu: Kundër, duke pasur në konsideratë që referuar metodologjisë dhe të gjithë standardit të ndjekur nga Këshilli deri tani bazuar në atë metodologji, nuk mund të kemi një pikëzim ndryshe të gjyqtarit bazuar në prova dhe në situatën që na referohet. Gjithsesi, duke ndarë të njëjtin shqetësim që ndau edhe zoti Hallunaj dhe të gjithë kolegët e tjerë lidhur me një pikëzim ndoshta jo fort të drejtë në këtë situatë për gjyqtarët, unë do i kërkoja Këshillit, që në një kohë sa më të shpejtë, të rishikohet pjesa e pikëzimit lidhur me këtë kriter për gjyqtarët, pra për angazhimin në trajnimin vazhdues, i cili është shumë i rëndësishëm. Por edhe të penalizohet me një diferencë kaq të madhe

4 dhe 20 pikë një gjyqtar që i ka plotësuar ditët, më duken ekstreme si vlerësime. Gjithsesi për propozimin unë jam kundër.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Kundër.

Klodian Kurushi: Pro propozimit, por pjesërisht jam dakord dhe për këtë pjesë unë bëj një propozim tjetër, për ta modifikuar propozimin e kolegut. Nuk jam dakord me 16, jam dakord me 20, sepse metodologjia zgjedh o 4, o 20, domethënë nuk ka pikëzim të ndërmjetëm. Për propozimet përtej pikëve unë jam dakord. Ekzistojnë për mua dy elemente shumë të rëndësishme, që në këtë rast duhen marrë në konsideratë: 1) ka qenë në proces vetingu në vitin e fundit dhe përkon pa vullnetin dhe dëshirën e gjyqtarit, dhe kjo i ka marrë kohë për të plotësuar edhe ato detyrime ligjore që parashikon ligji ynë përkatës dhe 2) nuk duhet ta lëmë mënjanë dhe pa vlerësuar faktin që Gjykata e Apelit Durrës ka qenë në mungesë gjyqtarësh dhe gjyqtari nga shtatori i 2021 e në vijim deri në fund të 2021 ka qenë edhe me detyrën e zëvendëskryetarit të gjykatës, që kërkon edhe kjo një impenjim tjetër. Kështu që pjesërisht dakord me propozimin, por në fund fare me pikëzimin unë do propozoja 20. Faleminderit!

Naureda Llagami: Kundër.

Naureda Llagami: Atëherë kalojmë në tërësi raportin sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Pro, me rezervën që thashë më lart.

Alban Toro: Dakord. *(Vota e zotit Toro nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Fatmira Luli: Pro.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit {...} për vitin 2021", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shumë mirë".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shumë mirë".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 16.01.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}", (relatore znj. Irena Plaku).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:11 dhe mbaroi në orën 14:34.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** ***(kryetare)***
2. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
3. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
4. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
5. ***Irena Plaku*** ***(anëtare)***
6. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
7. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
8. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
9. ***Marçela Shehu*** ***(anëtar)***
10. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Rezarta Taushani dhe Gentiana Agushi, Këshilltare pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf nga administrata e KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin etik dhe profesional, me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit (gradimit), për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016, të gjyqtares {...}", (relatore znj. Irena Plaku).

Naureda Llagami: Vazhdojmë sipas rendit të ditës në çështjen e dytë që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016. Për më shumë detaje, fjalën ia jap zonjës Plaku.

Irena Plaku: Faleminderit Kryetare!

Atëherë, para se të filloj të relatoj, sqaroj se nga ana e gjyqtares janë paraqitur disa kundërshtime, konkretisht janë protokolluar në KLGJ në datë 10.10.2022, nëpërmjet shkresës me nr. {...}, kundërshtime të cilat janë paraqitur edhe nëpërmjet e-mailit brenda afatit ligjor. Gjithashtu konstatoj (se tani u vura në dijeni) që nga ana e gjyqtares janë paraqitur konkluzionet lidhur me projektraportin e vlerësimit, e protokolluar me nr. {...}, datë 13.01.2023, për të cilën ju vura në dijeni sot. Gjithsesi, këto të fundit, me sa e lexova, janë përmbledhja e atyre kundërshtimeve të cilat gjyqtarja i ka paraqitur në datë 10.10.2022, të cilat unë do i lexoj në tërësi këtë të fundit, meqenëse juve nuk ju janë vënë në dispozicion më parë. Gjithashtu edhe unë nuk i kisha më parë në dispozicion. Tani u

vura në dijeni. Nuk ka paraqitur prova të reja, përveç atyre që ka paraqitur në datë 10.10.2022.

Procedura e vlerësimit të gjyqtares {...} ka filluar me vendimin nr. 22, datë 17.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pas dërgimit të dosjes me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit. Me këtë vendim, pas shortit të realizuar, janë përzgjedhur vlerësuesit. Në datë 18.01.2022, gjyqtarja është njoftuar nëpërmjet postës elektronike, dhe kjo e fundit më datë 20.01.2022 ka konfirmuar marrjen njoftimit dhe deklaruar se është dakord me vlerësuesit dhe nuk ka kërkesa për përjashtimin e tyre dhe çdo anëtari të Këshillit. Me procesverbalin e datës 19.01.2022, nëpunësi përgjegjës për vlerësimin, ka evidentuar çështjet dhe vendimet që janë administruar në dosjen e rivlerësimit, të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit. Me urdhrin e datës 25.02.2022 nga ana e relatores është disponuar për zhvillimin e shortit, përcaktimin e kategorisë së çështjeve që do të përzgjidhen për vlerësimin etik dhe profesional. Urdhri i është njoftuar gjyqtares dhe kancelarit të gjykatës me shkresën e datës 25.02.2022, si edhe nëpërmjet postës elektronike. Fillimisht shorti ishte planifikuar për t'u zhvilluar me datë 02.03.2022, por duke qenë se nëpunësja përgjegjëse për vlerësimin ka rezultuar pozitive me COVID është caktuar një datë tjetër, më datë 15.03.2022. Është rinjoftuar më datë 15.03.2022, për zhvillimin e shortit i cili është zhvilluar më datë 18.03.2022. Pas zhvillimit të shortit, janë protokolluar në KLGJ 6 (gjashtë) dosjet e reja të rihedhura në short.

Pas administrimit të 6 (gjashtë) dosjeve, me vendimin e datës 15.09.2022, Komisioni, pasi e gjeti të plotë dokumentacionin, vendosi vijimin e procedurës së vlerësimit dhe njoftimin e projekt-raportit të vlerësimit gjyqtares {...}. Aktet e përdorura në vlerësimin e aftësive profesionale nga organet e rivlerësimit të listuara si më poshtë: 1. Formulari i vetëdeklarimit të gjyqtarit; 2. Të dhënat e dosjes personale; 3. Të dhënat statistikore për periudhën e vlerësimit.

Siç e citova më sipër, gjyqtarja ka paraqitur disa kundërshtime dhe prova të reja. Për sa i përket statistikave gjyqtarja ka paraqitur disa prova të tjera, konkretisht: shkresa të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ku ajo ka ushtruar veprimtarinë gjatë periudhës së

vlerësimit si dhe Gjykatës Administrative të Apelit, të cilat pasi i kam verifikuar të gjitha këto të dhëna, ka rezultuar në fakt mospërputhje.

Konkretisht, referuar të dhënave statistikore për periudhën e vlerësimit tetor 2013 - tetor 2016, administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se: Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 – 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në dy gjykata të ndryshme. Kështu, në periudhën tetor 2013 – mars 2016, ajo ka kryer detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Prej datës 15 mars 2016 deri më sot ushtron detyrën e gjyqtares në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë. Gjyqtarja ka deklaruar në formularin e vetëvlerësimit se për vitet 2013 – mars 2016 i janë caktuar për gjykim 2470 çështje dhe ka përfunduar 1488 çështje dhe ka mbartur 1078 çështje. Sipas të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë për efekte të organizimit të shortit (të cilat janë të dhënat e mëparshme), rezulton se për periudhën tetor 2013 – mars 2016 gjyqtarja ka gjykuar 1237 çështje, nga të cilat 549 çështje themeli, 547 çështje civile, 2 çështje tregtare, 2 çështje penale, 441 kërkesa. Ka gjykuar në seksionin civil të përgjithshëm.

Lidhur me statistikat, gjyqtarja (siç relatova më sipër) ka paraqitur kundërshtime, duke paraqitur vërtetime të tjera nga Gjykata e Tiranës dhe Gjykata Administrative e Apelit. Për vitin 2013, sipas vërtetimit të parë ka rezultuar që ka gjykuar 147 çështje, nga të cilat 88 çështje civile themeli, 1 çështje tregtar, 40 kërkesa civile, 2 çështje penale dhe 16 masa sigurimi. Sipas vërtetimit me nr. {...} prot., datë 04.10.2022 të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se gjatë vitit 2013 (pra nuk është i ndarë nga tetori 2013 por për gjithë vitin) i janë caktuar 730 çështje të reja dhe ka përfunduar 516 çështje.

Për vitin 2014, ka përfunduar sipas vërtetimit të mëparshëm 489 çështje, nga të cilat 261 civile themeli, 1 çështje tregtar, 159 kërkesa civile, 3 kërkesa penale dhe 65 masa sigurimi.

Për vitin 2014, referuar vërtetimit të paraqitur, ka rezultuar që i janë caktuar në fakt 569 çështje dhe ka përfunduar 485 çështje në vit.

Për vitin 2015, ka përfunduar 529 çështje, nga të cilat 158 civile themeli, 207 kërkesa, 162 masa sigurimi.

Për vitin 2015, sipas vërtetimit të ri i janë caktuar për gjykim 647 çështje dhe ka përfunduar 529 çështje.

Për vitin 2016 (sipas vërtetimit të mëparshëm) ka rezultuar që i janë caktuar 77 çështje, nga të cilat 42 civile themeli, 32 kërkesa civile, 3 masa sigurimi.

Për vitin 2016, siç e relatuam më sipër, gjyqtarja ka ushtruar detyrën deri më 15 mars, pasi nga 15 marsi është caktuar në gjykatën e apelit, dhe sipas vërtetimit të ri të paraqitur, rezulton që i janë caktuar 67 çështje dhe ka përfunduar 67 çështje (në kushtet kur dosjet e mëparshme janë rishortuar).

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë për efekte të organizimit të shortit, rezulton se për periudhën... konkretisht shkresës {...} prot., datë 14.12.2018, rezulton se për periudhën mars 2016 (data që ka marrë emërimin) – tetor 2016, pra një periudhë 8-mujore (apo 7 mujore duke hequr muajin gusht kur gjyqtarët dhe administrata kryejnë lejen e zakonshme) gjyqtarja ka përfunduar 235 çështje nga të cilat 104 administrative dhe 131 marrëdhënie pune.

Nga statistikat e reja të paraqitura nga gjyqtarja, nëpërmjet vërtetimit nr.{...} prot., datë 19.04.2022, rezulton se gjyqtarja ka filluar të hidhet në short (janë paraqitur dy vërtetime që paraqesin të njëjtën datë), në datë 01.04.2016 dhe sipas këtij vërtetimi rezulton se gjyqtares i janë caktuar gjatë vitit 2016, 630 çështje, dhe ka përfunduar 402 çështje deri në fund të këtij viti. Ndërsa për periudhën deri në datën 08.10.2016 rezulton se ka përfunduar 257 çështje.

Burim vlerësimi janë edhe dosjet e përzgjedhura me short në procesin e rivlerësimit kalimtar (5 dosje), 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja.

Nuk rezulton që të ketë vendime të administruara për shkak të ankesave ose kryesisht nga organet e vlerësimit. Janë marrë si burim vlerësimi edhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ–së.

Analiza e të dhënave të marra nga burimet e vlerësimit dhe propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter.

Sa i përket kriterit të parë, nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se: - Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes, gjyqtarja referuar objektit të mosmarrëveshjes/natyrës së çështjes, i kushton rëndësi të veçantë

përshkrimit të detajuar dhe analitik të fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale ashtu edhe fakteve që lidhen me themelin e çështjes, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsyetimit të vendimit. Paraqitja e rrethanave procedurale përbën pjesë të rëndësishme edhe pse nuk është e ndarë në një nënndarje të veçantë, në të cilën përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, evidentohet sipas rastit ecuria procedurale e çështjes lidhur me (i) kundërshtimin e veprimeve përmbarimore, (ii) vlerësimi i gjykatës lidhur me elementë të kompetencës lëndore ose tokësore në shqyrtimin e çështjes kryesisht në çështjet lidhur me marrëdhëniet e punës, kundërshtim veprimesh përmbarimore apo paditë për shfuqizimin e vendimeve të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, (iii) vlerësimi i gjykatës lidhur me kërkesa të pushimit të cenimit të pronës, etj.

Në të gjitha vendimet burim vlerësimi të cilat lidhen me shqyrtimin e çështjeve te themelit përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqëruar me vlerësimin dhe analizën ligjore të gjykatës lidhur me këto elementë, posaçërisht në rastet kur ato konsistojnë në shqyrtimin e kërkesave procedurale të palëve, i jep qartësi vendimit dhe orienton lexuesin lidhur me elementë të tillë si objekti i padisë, shkaku ligjor i saj, ndërgjyqësia, zhvillimin e gjykimit në prezencë ose mungesë të palëve, etj.

Karakteristikë e gjyqtares është se këto elementë përshkruhen e merren në analizë pas pasqyrimit të rrethanave të faktit të vendimit gjyqësore, duke filluar analizën juridike të vendimit. Lidhur me përcaktimin e natyrës së çështjes, në të gjitha vendimet e analizuara, gjyqtarja identifikon dhe përcakton qartë dhe në mënyrë të shprehur natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtares, duke u bërë në mënyrë të shprehur dhe në disa raste si pasojë e një analizë ligjore të shkakut dhe objektit të padisë, pasi në çështjet civile, ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të gjykatës, duke cituar dhe analizuar për këtë qëllim edhe dispozitat procedurale në lidhje me kompetencën lëndore dhe tokësore. Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm, në të gjitha vendimet gjyqësore burim vlerësimi rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke cituar në përmbajtjen e

vendimit dispozitat e ligjit procedural dhe material të cilat merren në analizë në lidhje me zgjidhjen e çështjeve të karakterit procedural apo zgjidhjen në themel të çështjes.

Sa i përket ligjit material, referuar burimeve të vlerësimit në tërësinë e tyre, rezulton se gjyqtarja identifikon dhe/ose citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi.

Në tërësi, rezulton se aftësia e gjyqtares për paraqitjen dhe analizës e plotë të fakteve, si atyre me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen me trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat paraqiten në mënyrë të detajuar, të plotë dhe analitike, duke integruar provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit tërësor të tyre. Po ashtu rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të qartë të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin e arsyetimit dhe analizës ligjore lidhur me zgjidhjen e çështjes. Shkalla e aftësisë për këtë nënkriter është vlerësuar “Shumë e lartë”, duke u pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket nënkriterit “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes”, në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike civile (procedurale dhe materiale) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar në çdo rast me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin literal apo sistematik të normave, interpretim i cili duke e përqasur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara,

sjell si pasojë logjike konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Në vendimet e dhëna, përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj por duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë që të gjejë zbatim norma konkrete, në përputhje me faktin dhe provat e administruara në gjykim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se gjyqtarja: Merr në analizë nenin 92/b të Kodit Civil duke interpretuar veprimet absolutisht të pavlefshme të kryera në kundërshtim me ligjin dhe në mashtrim të ligjit duke e lidhur me analizën e nenit 67 të Kodit Civil duke interpretuar tagrat e përfaqësuesit dhe përmbajtjen e veprimit juridik të kryer nga përfaqësuesi nën dritën e Vendimit Unifikues nr. 1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; - Merr në analizë nenin 1/1 dhe 3 të ligjit "Për reformën agrare" bashkë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vitit 1976 ku interpreton shpronësimin e detyrueshëm si rrjedhojë e mungesës së të drejtës për pronë private si edhe bën një interpretim abstrakt të së drejtës së pronës; - Nëpërmjet interpretimit të dispozitave të Kodit të Punës dhe konkretisht të neneve, gjyqtarja identifikon si ligj të zbatueshëm nenet 3, 4, 5, 6, 7, 12, 22-26, 140, 141-152, të Kodit të Punës, analizon dhe vlerëson zbatimin e Kodit të Punës në hapësirë, kohë, ndaj personave dhe sipas materies. Interpreton dispozita të këtij Kodi (nenin 7 të Kodit të Punës) në raport me dispozitat e K.Pr.Civile që përcaktojnë kompetencën lëndore dhe tokësore, në funksion të konkluzionit lidhur me këto elementë, duke integruar në interpretimin e saj edhe parimin e zbatimit të ligjit të posaçëm si dhe qëndrimet e praktikës gjyqësore duke referuar Vendim Unifikues të Kolegjeve të Bashkuara. Në funksion të vlerësimit lidhur me marrëdhënien e punës mes palëve, kohëzgjatjen e saj, formën e kontratës, përmbajtjen e saj, gjyqtarja interpreton nenin 12 të Kodit të Punës për të konkluduar sipas rastit për llojin e kontratës, në funksion të përcaktimit të dispozitave që gjejnë zbatim në rastin konkret. Pas kësaj analize, gjyqtarja ndalet në interpretimin e neneve 143, 144, 153 të Kodit të Punës, duke analizuar çështje të afatit, procedurës dhe shkaqeve të arsyeshme apo të justifikuara për zgjidhjen e marrëdhënies së punës; - Merr në analizë nenet 296 dhe 302 të Kodit Civil dhe bën një interpretim abstrakt të padisë mohuese dhe padisë së rivendikimit duke treguar ndryshimet mes tyre; - Një interpretim të tillë abstrakt bën

edhe për nenet 52 të Kushtetutës dhe nenit 31 të ligjit "Për sigurimet shoqërore", i ndryshuar, ku interpreton të drejtën e individit për të përfituar pension. Për sa i përket interpretimit të dispozitave procedurale, gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës, jo vetëm për sa i përket aspekteve meritore, por edhe atyre procedurale në rastin kur ngrihen çështje të procedurës, me kërkesë të palëve apo kryesisht, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel. Konkretisht: - Merr në analizë nenin 32/a të K.Pr.Civile duke interpretuar interesin e ligjshëm të pronarit për të ngritur padi që ka lidhje me sendin dhe të drejtat reale mbi të, për të përfituar të drejta reale personale, kur cenohen interesa ekonomiko-financiare; – Nëpërmjet interpretimit të nenit 32/c të K.Pr.Civile, dhe neneve 388 dhe 389 të po këtij Kodi, gjyqtarja ndalet në analizën e natyrës njohëse të padisë, përcaktimin e legjitimitetit aktiv të palës paditëse, përcaktimin e shkakut ligjor të padisë dhe objektin e të provuarit në rastet e këtyre padive. Në një rast që ka të bëjë me vërtetimin gjyqësor të faktit të vdekjes dhe të drejtat pasurore dhe personale që lidhen me këtë fakt, gjyqtarja interpreton nenin 388 dhe 389 të K.Pr.Civile; – Merr në analizë nenin 36 të K.Pr.Civile në lidhje me juridiksionin (Vendimin e Gjykatës së Lartë me nr. 560, datë 30.10.2014); – Në çështjet civile të themelit, gjyqtarja interpreton nenet e K.Pr.Civile në mbështetje të argumenteve në lidhje me përcaktimin e të drejtës së padisë dhe elementëve të saj, duke iu referuar në mënyrë të posaçme padisë së njohjes për vërtetësinë ose pavërtetësinë e shënimeve, padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv apo padinë për kundërshtimin e veprimeve përmbarimore (nenet 609, 610 dhe 616), në lidhje me pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, pezullimin dhe pushimin e veprimeve përmbarimore; vlerësimin lidhur me çështje të juridiksionit, kompetencës lëndore, etj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtares që, në mbështetje të interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsyetimit të vendimit. Gjyqtarja njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit siç janë: – Në vendimin me objekt kundërshtim i zgjidhjes pa shkaqe të arsyeshme të kontratës së

punës gjyqtarja citon parimin e mosdiskriminimit, të sanksionuar në nenin 9 të Kodit të Punës. Në lidhje me aftësinë e gjyqtares për të përdorur jurisprudencën relevante... – Në vendimin civil me objekt kundërshtim i veprimeve përmbarimore, referon vendimin nr. 1/2009 të Kolegjeve të Bashkuara lidhur me interpretimin për sa i përket vlefshmërisë së veprimit juridik për kalimin e pronësisë të sendeve të paluajtshme (nenet 79, 663, 659 të Kodit Civil) si dhe në vendim civil me objekt konstatimin e pavlefshmërisë së veprimit juridik, kontratë shitje; – Në vendimin civil me objekt detyrimin për njohjen bashkëpronar, gjyqtarja identifikon vendimin nr. 560, datë 30.10.2014 të Gjykatës së Lartë; – Në vendimin civil me objekt kundërshtim i zgjidhjes pa shkaqe të kontratës së punës, gjyqtarja identifikon qëndrimin e mbajtur nga Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës; - Në vendimin me nr.10604, datë 25.10.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lidhur me konkluzionin për procedurën e lëshimit të urdhrit të ekzekutimit, etj.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në funksion të vlerësimit të çështjeve me karakter procedural apo në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje zgjidhjen në themel të çështjes. Po ashtu, rezulton një kujdes i gjyqtares për të identifikuar dhe zbatuar praktikën relevante gjyqësore unifikuese në rastet e nevojshme, atë të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdesi për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural ashtu edhe në thelbësor.

Për këtë tregues është propozuar vlerësimi i saj për aftësi “Shumë të lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Sa i përket “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit”, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtarja gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore përfundimtare, është e thjeshtë, e qartë dhe e kuptueshme, në mënyrë që vendimi të kuptohet jo vetëm nga njohësit e ligjit. Në përdorimin e instituteve të së drejtës, parimeve apo të drejtave të pjesëmarrësve në proces, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, shoqëruar me kuptimin e termit/shprehjes përkatëse në gjuhën shqipe, duke i bërë të kuptueshme për lexuesin. Po ashtu, në referimin e

fjalëve me karakter teknik, kryesisht si pasojë e referimit në ligje të posaçëm me karakter specifik, përdorimi i termave teknikë është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij ose rezulton i qartë nga konteksti i arsyetimit. Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimin e fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fyes apo denigrues. Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, evidentohet kujdesi i gjyqtares për përzgjedhjen e gjuhës së përdorur, me qëllim shmangien e fjalëve apo shprehjeve, pavarësisht mënyrës së formulimit të tyre nga palët, duke pasur në vëmendje respektimin e të drejtave të subjekteve të procedimit.

Në arsyetimin e vendimeve rezulton se gjyqtarja zbaton rregullat gramatikore, të sintaksës dhe morfologjisë, në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të faktit, rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes apo shprehjes së mendimit juridik të saj. Përgjithësisht, rezulton në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç). Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nënndarjet e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi, në lidhje me kuptimin e tyre.

Në vendimet përfundimtare burim vlerësimi gjyqtarja pasqyron dhe merr në analizë në çdo rast elementët proceduralë si kompetenca, juridiksioni, të drejtat e palëve, njoftimi i tyre, trajtimin e kërkesave të palëve ndërgjyqëse gjatë procesit gjyqësor dhe vendimmarrjet prospektive të gjykatës lidhur me to, pavarësisht se nga përmbajtja e vendimit, jo në çdo rast këto elementë kanë qenë të diskutueshëm nga palët apo rrethanat e çështjes. Në vendimet burim vlerësimi pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur pretendimet dhe prapësimet e palëve, të cilat merren në analizë nga gjyqtarja në mënyrë specifike në pjesën arsyetuese të vendimit. Po kështu, në shumicën e vendimeve të analizuara, evidentohet vendosja e plotë e tekstit të dispozitave ligjore të zbatueshme, edhe pse jo gjithmonë është vijuar në pjesën e argumentimit ligjor të gjykatës apo me analizën dhe zbërthimin e dispozitave të cituara.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja i kushton rëndësi të posaçme arsyetimit të vendimeve në drejtim të qartësisë

dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkruese, pavarësisht trajtimit të gjerë të çështjeve me karakter procedural edhe kur ato nuk kanë qenë pjesë e pretendimeve të palëve. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares për këtë tregues propozohet "Shumë e lartë" duke u pikëzuar me 15 pikë.

"Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit" – Gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet në çdo rast. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkruese arsyetuese në: rrethanat e faktit, arsyet pse paditësi ka ngritur padi, prapësimet e palës së paditur dhe arsyetimin ligjor të vendimit të ndarë me pika të veçanta ku merr në shqyrtim të gjitha çështjet e ngritura si nga palët ashtu edhe kryesisht (si juridiksioni, kompetenca, e drejta për të ngritur padi etj). Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese - arsyetuese, si dhe dispozitivin. Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në proces, në mënyrë të përmbledhur. Pjesa përshkuese arsyetuese është e ndarë në: rrethanat e faktit, arsyet pse paditësi ka ngritur padi, prapësimet e palës së paditur dhe arsyetimin ligjor të vendimit të ndarë me pika të veçanta ku merr në shqyrtim të gjitha çështjet e ngritura si nga palët ashtu edhe kryesisht (si juridiksioni, kompetenca, e drejta për të ngritur padi etj), megjithëse jo gjithmonë e ndarë me nëntituj. Në pjesën e parë të përshkrimit të rrethanave të faktit gjyqtarja përshkruan dhe analizon faktet thelbësore të çështjes të integruara me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim së bashku me analizën e tyre. Në pjesën e dytë paraqiten arsyet e ngritjes së padisë nga paditësi dhe provat dhe argumentet ku e mbështet ngritjen e padisë. Në pjesën e tretë paraqiten prapësimet e palës së paditur dhe provat dhe argumentet ku mbështeten ato. Në pjesën e arsyetimit ligjor gjyqtarja citon nene të ligjit material dhe procedural që zbatohet në çështjen konkrete, duke referuar dispozitat materiale civile, por edhe ato të ligjit të posaçëm në të cilën të referon fakti juridik civil për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, duke bërë interpretimin abstrakt të tij, para aplikimit mbi faktet konkrete.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës dhe data e shpalljes së vendimit. Konstatohet gjithashtu se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim jo vetëm disponimi i gjykatës mbi padinë e evokuar nga paditësi (pranimin apo rrëzimin e kërkesë padisë), por edhe se kujt i ngarkohen shpenzimet gjyqësore. Gjithashtu në të gjitha vendimet pasqyrohet e drejta e ankimit dhe afati i ushtrimit të saj.

Në tërësi, nga pikëpamja e përmbajtjes, mënyra e të shkruarit të vendimeve është e qartë dhe e mirëstrukturuar, gjithmonë sipas këtij rendi: rrethanat e faktit, arsyet pse paditësi ka ngritur padi, prapësimet e palës së paditur dhe arsyetimin ligjor të vendimit të ndarë me pika të veçanta ku merr në shqyrtim të gjitha çështjet e ngritura si nga palët ashtu edhe kryesisht. Në përgjithësi konstatohet që për nënndarje të vendimit të jenë fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike. Në lidhje me këtë tregues “Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit” është propozuar aftësia e gjyqtares “Shumë e lartë” duke u pikëzuar me 10 pikë.

“Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” – Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi “shumë të lartë” në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtares në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsyetimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe evidentohet interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

Për kriterin “Aftësitë profesionale të gjyqtares”, niveli i vlerësimit është propozuar "Shkëlqyeshëm", pikët 100.

Për sa i përket “Aftësive organizative të gjyqtares”, vetëm në këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet e saj së bashku me provat, me të cilat ju jeni njohur paraprakisht, një pjesë e të cilës do integrohen bashkë me relacionin lidhur me këtë çështje. Gjithashtu do lexohen edhe konkluzionet në përfundim paraqitur nga ana e gjyqtares me shkrim.

“Respektimi i afateve ligjore” – Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të behët duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe një çështjeve të trajtuara si pasojë e ankesave. Në Kodin e Procedurës Civile, për çështjet civile të themelit, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre. Në nenin 48 pika 2, të Ligjit nr. 49/2012, përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjet brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi, që do të thotë nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë. Gjithashtu, në nenin 10 pika 2, germa b), përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj. Në ligjin nr.49/2012 nuk janë përcaktuar afate për gjykimin e padive në shkallë të parë nga gjykata administrative e apelit. Por vetë ligji i posaçëm mund të parashikojë afate për gjykimin e këtyre padive në shkallë të parë nga Gjykata Administrative e Apelit. Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve rezulton se vetëm në 4 (katër) prej tyre parashikohen afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes; Për 4 (katër) çështjet për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, sikundër referohet më sipër, 3 (tre) prej tyre kanë përfunduar në tejkalim të afatit ligjor, pra gjyqtarja rezulton të ketë gjykuar 75% të çështjeve jashtë afatit ligjor. Referuar tabelës së pikëzimit për këtë tregues, të përcaktuar në rregulloren nr. 264/2019, kjo përqindje ekuivalentohen me 3 pikë. Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e

vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Janë marrë dosjet të cilat janë jashtë afatit dhe janë analizuar në projektraport në mënyrë të detajuar. Për sa i përket dosjes që i përket vendimit nr. 279, datë 17.01.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt- kundërshtim i veprimeve përmbarimore, rezulton se natyra e këtij gjykimi nuk ka qenë komplekse. Megjithatë gjyqtarja duket se ka marrë të gjitha masat për përfundimin e saj brenda një afati të shkurtër, duke caktuar seanca brenda një afati të shkurtër kohor, brenda 5 ditësh, në një rast brenda 10 ditësh dhe vetëm në një rast brenda 18 ditësh, por edhe kjo e kushtëzuar me faktin se në muajin janar të çdo viti (përgjithësisht deri në 15 Janar), në gjykatën e rrethit gjyqësor Tiranë bëhen mbartjet e dosjeve të vitit të mbyllur dhe nuk bëhen veprime në sistemin e gjykatës, çka e bën të pamundur zhvillimin e gjykimeve. Kështu po të zbresim afatin 15–ditor, rezulton se gjykimi i kësaj dosje ka përfunduar për një afat prej 30 ditësh, duke e tejkaluar afatin e gjykimit me 10 ditë. Gjithashtu, po të shikojmë edhe faktin se një seancë është shtyrë për shkak të pamundësisë së gjyqtares për të qenë në punë për arsye shëndetësore (vërtetuar kjo me raport shëndetësor), dhe faktin se gjykata ka caktuar seanca të afërta, rezulton se gjykimi ka përfunduar brenda 20 ditëve, pra brenda afatit ligjor. Kështu për 4 çështjet të cilat parashikojnë afat ligjor vetëm 2 prej tyre do të konsiderohen të gjykuara tej afatit ligjor, pra duke zbritur me 50%, megjithatë edhe kjo përqindje sipas metodologjisë së vlerësimit pikëzohet me 3 pikë. Por ka rezultuar që këto 2 çështje i përkasin Gjykatës Administrative të Apelit. Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për periudhën 3-vjeçare objekt vlerësimi 1237 çështje pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (këtu janë vetëm statistikat që kanë qenë më përpara), nga të cilat 549 çështje themeli (civile, penale dhe tregtare), 441 kërkesa (3 kërkesa penale dhe 438 kërkesa civile) dhe 245 masa sigurimi. Pra sipas statistikave të para ka rezultuar 551 çështje me palë kundërshtare deri në datën 15.03.2016 dhe prej kësaj date ajo ka gjykuar 235 çështje në Gjykatën Administrative,

sipas vërtetimit të parë të dhënë nga Gjykata Administrative, në bazë të të cilit është kryer edhe shorti.

Po t'i referohemi kësaj përqindjeje, rezulton se në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mesatarisht ajo ka gjykuar 229 çështje në vit (çështje me palë kundërshtare, sepse kërkesa të tjera ka akoma më shumë).

Ndërsa në Gjykatën Administrative ajo ka gjykuar 257 çështje për periudhë prej 6 muajsh, deri në datën 08.10.2016, referuar faktit se nga data 1 prill është hedhur në short.

Referuar vërtetimit të paraqitur nga ana e gjyqtares, rezulton se në fakt, deri në përfundim të vitit 2016 ajo ka gjykuar rreth 42 çështje, ndërsa si anëtare e trupit gjykues deri në datën 8.10. ka gjykuar rreth 157 çështje, që i bie deri në përfundim të gjykimit, ka gjykuar rreth 300 çështje si anëtare. Pra duke e tejkaluar standardin minimal në Gjykatën e Apelit me rreth 189%, edhe në Gjykatën e Tiranës ka një standard minimal me gati 100%.

Në lidhje me aspektin e rritjes së papritur të volumit të çështjeve, rezulton se gjatë vitit 2013, sipas statistikave të reja, janë caktuar 730 çështje civile, nga të cilat 458 çështje civile themeli, dhe ka përfunduar 516, duke mbartur 210 çështje.

Në vitin 2014, i janë caktuar rreth 569 çështje dhe ka përfunduar 485 çështje, nga të cilat 262 çështje civile, duke mbartur 84 çështje.

Gjatë vitit 2015, i janë caktuar 647 çështje dhe ka përfunduar 529 çështje, ka mbartur 161, ndërsa deri në muajin mars 2016 i janë caktuar 67 çështje dhe ka përfunduar 67.

Gjatë vitit 2016, prej datës 15.03.2016, gjyqtarja është caktuar në Gjykatën Administrative të Apelit, por në fakt në short ka rezultuar se është hedhur në datë 01.04.2016 (referuar vërtetimeve të reja të paraqitura nga Gjykata Administrative e Apelit). Asaj i janë caktuar 630 çështje dhe ka përfunduar 402, ku deri në datë 08.10.2016 ajo ka gjykuar 154 çështje si anëtare.

Po t'i referohemi periudhës së gjykimit pranë kësaj gjykate, si dhe numrit të çështjeve të përfunduara, duke e marrë vitin të plotë, referuar edhe të dhënave të fundit të paraqitura, vërtetimit të lëshuar nga gjykata administrative e apelit, datë 19.042022, vërtetim i cili siç e relatova më sipër është paraqitur në Këshill në datë 10.10.2022,

rezulton se ajo është hedhur në short në datë 01.04.2016. Duke pasur parasysh procedurën e gjykimit, vlerësohet se vendimet e para ajo mund t'i ketë dhënë në fund të muajit prill. Po kështu për një periudhë rreth 8 muaj të plotë ajo ka dhënë rreth 50.25 vendime në muaj, apo rreth 2.4 vendime në ditë, referuar ditëve mesatare të punës në muaj prej 21 ditë. Pra mund të themi se trendi i çështjeve të regjistruara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka ardhur duke rënë, ndërsa numri i çështjeve të gjykuara ka vijuar me në të njëjtën mesatare. Ndërsa në Gjykatën Administrative të Apelit, numri i çështjeve ka qenë tepër i lartë, duke e bërë të pamundur gjykimin e tyre brenda afatit ligjor, rrethanë që del tej vullnetit dhe mundësisë së gjyqtares.

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 50%, pasi kemi zbritur çështjen me objekt kundërshtim i veprimeve përmbarimore, të cilën gjyqtarja ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) faktin se dy çështje që janë gjykuar jashtë afatit i përkasin periudhës kur ajo ka gjykuar si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit; (iii) ngarkesën e gjyqtares si relatore nga data 15.03.2016 – 08.10.2016 (ku ka rezultuar se ka gjykuar 257 çështje), që është një periudhë më pak se 6 muaj, ndërsa deri në fund të vitit, që janë edhe dy muaj të tjerë, ajo ka gjykuar rreth 402 çështje; (iii) rritja e papritur të volumit të punës në vitin 2016 që i përkasin dhe periudhës që çështjet janë gjykuar (konkretisht për një periudhë 8–mujore) duke iu caktuar 630 çështje, gjyqtarja për këtë tregues, pasur parasysh se rendimenti i saj ka dalë me 189%, vlerësohet duke u pikëzuar me 15 pikë, domethënë propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

Edhe për këtë nëntregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, por në fakt ajo është pikëzuar me pikët maksimale.

"Plotësimi i standardeve minimale kohore" – Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se: Për 10 (dhjetë) çështjet e vëzhguara për të cilat nuk parashikohet afat ligjor gjykimi, vetëm për 7 çështje ka të dhëna që mund të analizohen, pasi për 3 çështjet e përzgjedhura nga gjyqtarja nuk kemi të dhëna të mjaftueshme për të vlerësuar kohëzgjatjen e proceseve dhe një çështje e trajtuar për shkak të ankesave. Nga vëzhgimi i këtyre 8 çështjeve për të cilat nuk parashikohet afat ligjor, gjykimi ka

përfunduar brenda/jashtë standardit minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish-KLD–së në varësi të çështjes. Në analizë janë saktësuar të gjitha dosjet.

Një çështjet e referuara për vlerësim etik dhe profesional, sipas të dhënave arkivore të KLD–së, rezulton vetëm një çështje, siç u relatua.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 8 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore dhe ka të dhëna, rezultoi se të 3 (tre) çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimal kohor prej 6 muajsh dhe 5 (pesë) çështje jashtë standardit prej 2 dhe 6 muajsh. Pra në total 62.5% të çështjeve janë jashtë standardit minimal kohor.

Përqindja matematikore prej 62.5% përkon me nivelin e vlerësimit 1 (një) pikë, sipas metodologjisë të miratuar me vendimin me nr. 264. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Pavarësisht se për 62.5% të çështjeve të shqyrtuara, rezulton tejkalim i standardit minimal kohor të pranuar prej 2 dhe 6 muaj, rezulton se kjo ka qenë dhe pasojë e ecurisë procedurale të çështjes, në disa raste për shkak të kërkesave të palëve për paraqitjen e prapësimeve me shkrim apo provave shkresore, mungesës së palëve, kërkesave për shtyrje të palëve (rast vdekje apo qenie në gjykime të tjera), kërkesave për saktësimin e objektit të padisë, mosparaqitjes së gjyqtares për arsye shëndetësore (ku vetëm në 6 dosje ka pasur 7 raporte shëndetësore) apo për shkak të qenies në seminar, angazhimi i saj me gjykimin e masave të sigurimit personal, marrjes së provës me ekspert, etj.

Nga ana tjetër në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (periudhë që janë dhe çështjet që parashikojnë standarde minimale kohore), gjyqtarja ka përfunduar në total për 2 vite e 5 muaj periudhë vlerësimi (08.10.2013 – 15.03.2016), 551 çështja, ndërsa duke e marrë vitin të plotë rezulton se ka gjykuar 680 çështje civile themeli. Pra mesatarisht gjyqtarja ka gjykuar rreth 229 çështje në vit, ndërkohë që minimalisht duhet të shqyrtonte jo më pak se 120 çështje themeli në vit, referuar vendimit 261/2, duke qenë mbi standardin minimal të shqyrtimit të çështjeve në masën 90.8%, ngarkesë në punë që e justifikon pikëzimin e gjyqtares me një nivel të ndryshëm nga ai që i përket përqindjes...

Atëherë, për sa më sipër për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

(i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit minimal;

(ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nga dosjet e vëzhguara, ku rezultoi se disa herë çështje është shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtares për arsye shëndetësore (e vërtetuar këto me raporte shëndetësore) dhe përgjithësisht ka marrë masa konkrete për zhvillimin e tyre dhe për eliminimin e shkaqeve të shtyrjes, natyrës komplekse të disa çështjeve, numrit të lartë të seancave gjyqësore, ku vetëm në 6 dosjet e përzgjedhura rezulton të ketë munguar për arsye shëndetësore të përligjura në të paktën 7 seanca, ku minimalisht për një shtyrje seance është shtyrë së paku për 15 ditë;

(iii) afatin e tejkalimit të standardit minimal, i cili referuar afatit të gjykimit varion nga 1 muaj e disa ditë, afat që në Gjykatën e Tiranës nuk është i lartë, në 3 dhe 6 muaj, duke e tejkaluar afatin me dyfishin e saj në dy çështje.

(iv) gjykimi me mbi 90%, vetëm për Gjykatën e Tiranës, gati 91% ka rezultuar me statistikat e para niveli i standardit, por siç e relatova më sipër ka pasur ndryshime të statistikave, ku ndër të tjera rezulton se gjyqtarja përgjatë këtyre viteve ajo ka përfunduar, ndër të tjera, përveç çështjeve të themelit që ishin 628, rreth 891 kërkesa civile, masa sigurimi dhe urdhra ekzekutimi të cilat parashikojnë afatin ligjor.

Për të gjitha këto arsye, pasi kam marrë në konsideratë edhe statistikat e reja, ngarkesën e përgjithshme në punë të gjyqtares, propozoj rritjen e vlerësimit me një nivel tjetër. Këtu në fakt ishte bërë edhe një gabim në pikëzim. Ishte pikëzuar 4 dhe këtu ishte shkruar 3. Kështu që unë propozoj rritjen me një nivel, duke e çuar në 5 pikë.

"Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje" – Po kaloj në konkluzione. Edhe këtu është marrë për 7 çështje të dhënat, se vetëm për 7 çështje ka të dhëna, ndërsa për të tjerat nuk ka të dhëna.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (8 çështjet e marra në analizë ku 7 janë çështjet të cilat janë marrë me short dhe 1 është për shkak të ankesave), rezulton se:

(i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 7 (shtatë) çështjet në kategorinë e çështjeve "civile themeli", rezulton të jetë rreth 327 ditë, ose afërsisht 10.9 muaj, pra më e gjatë se standardi minimal prej 6 muajsh.

(ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështjet në kategorinë e çështjeve "kërkesë civile pa palë kundërshtare", rezulton të jetë rreth 120 ditë, 3 muaj e 29 ditë, jashtë standardit minimal kohor prej 2 (dy) muaj.

Kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara është më e gjatë se standardi për të gjithë kategoritë e çështjeve, duke u tejkaluar standardi kohor minimal i gjykimit me rreth 4.9 muaj tek gjykimet civile të përgjithshme dhe me 1 muaj e 29 ditë në çështjet pa palë kundërshtare. Referuar metodologjisë së Pikëzimit, kjo përqindje i përkon pikëzimit me 1 pikë. Mbështetur në të njëjtën analizë si treguesi më sipër (treguesi "2.A.b Plotësimi i standardeve minimale kohore"), konkretisht duke marrë në konsideratë shkaqet e shtyrjes dhe të zgjatjeve të gjykimeve, të cilat kanë qenë kryesisht për shkaqe procedurale, mungesës së gjyqtares për arsye të përligjura (raport shëndetësore) por edhe të mungesës së njoftimeve të palëve, kompleksitetit të çështjeve, ngarkesën e gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit, faktin se ajo e ka tejkaluar standardin minimal me 90.8 % vetëm në Gjykatën e Tiranës, ku afërsisht me statistikat e reja shkon më shumë se 90 e ca për qind (jo 100% kuptohet), ndërsa në Gjykatën Administrative të Apelit përqindja i ka kaluar 189%, vlerësoj që niveli i vlerësimit duhet të jetë më i lartë se ai që i korrespondon pikëzimit të përcaktuar në tabelën përkatëse, duke e pikëzuar me 5 pikë.

Referuar sa më sipër vlerësoj se në lidhje me këtë tregues, gjyqtarja duhet të pikëzohet nga 3, në 5 pikë.

"Rendimenti i përfundimit të çështjeve" – Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: "Lidhur me ngarkesën sasiore, ajo deklaron se në vitin 2014 ka përpunuar 421 çështje; në vitin 2015 ka përpunuar 365 çështje dhe në vitin 2016 ka përpunuar 476 çështje.

Në fakt ka rezultuar se për vitin 2013 gjyqtarja ka përfunduar 516 çështje. Në vitin 2014 ka përfunduar 485 çështje dhe në vitin 2015, 529 çështje. Në vitin 2016, ku ka gjykuar deri në mars, 67 çështje. Mesatarisht rreth 514 çështje në vit.

Nga analiza e të dhënave, pasi janë marrë edhe statistikat e reja, referuar të dhënave të deklaruara nga gjyqtarja si dhe të dhënave statistikore të përcjella së fundi edhe nga dy gjykatat, ka rezultuar se në vitin 2014 gjyqtares i janë caktuar 569 çështje dhe ka përfunduar me vendim përfundimtar 485 çështje, ka mbartur 84, nga të cilat 138 kanë qenë masa sigurimi, ku rendimenti del 85.3%; gjatë vitit 2015 i janë caktuar për gjykim 647 çështje dhe ka përfunduar me vendim përfundimtar 529 çështje, ka mbartur 118, nga të cilat 64 kanë qenë masa sigurimi të cilat janë me afat ligjor, rendimenti del 82%; gjatë vitit 2016 i janë caktuar për gjykim 67 çështje dhe ka përfunduar me vendim përfundimtar 67 çështje, po të vlerësojmë përqindjen rezulton 100 %. Pra mesatarja e tre viteve del rreth 89 %.

Në Gjykatën Administrative të Apelit, duke e konsideruar vit kalendarik të plotë vitin 2016 (pra duke e marrë të plotë 2016 ashtu siç i kemi marrë edhe gjyqtarët e tjerë), gjyqtarja {...}, sipas të dhënave në formularin e vetëdeklarimit për aftësitë profesionale, por edhe vërtetimit të lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit, të paraqitur rishtazi, nëpërmjet shkresës nr. {...} prot., datë 19.04.2022, të paraqitur nëpërmjet shkresë së protokolluar në Këshill nr.{...}, datë 10.10.2022, rezulton se asaj i janë caktuar 630 çështje dhe ka përfunduar rreth 402 çështje si relatore, ndërsa deri në 08.02.2016 ka përfunduar në fakt 257 çështje, ndërsa 154 deri në datë 08.10. ka qenë si anëtare (po ta marrim deri në fund, shkon si anëtare rreth 300 çështje të tjera).

Në fakt kam bërë edhe një tabelë të atyre që relatova më sipër, ku rezulton rendimenti i llogaritur me përqindjen e mëparshme dhe rendimenti i ndryshuar pas paraqitjes së statistikave të reja. Po të mbledhim përqindjen e të gjithave, vetëm në Gjykatën Administrative të Apelit rezulton që 63%, duke referuar 85, 82, 100% (del rendimenti për tre vitet). Pasur parasysh që viti 2016 është ulur për shkak të Gjykatës Administrative, pasi ka dalë 63%, referuar se janë caktuar 630 dhe ka mbaruar 402; Rezulton se rendimenti i përgjithshëm del 77% nga 54 që ka dalë më përpara.

Megjithatë, po t'i referohem periudhës që gjyqtarja ka punuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë e cila është periudha më e gjatë e vlerësimit, rezulton se rendimenti për dy vitet e plotat të punës del rreth 83.65% apo rreth 84% e cila referuar metodologjisë pikëzohet me 4 pikë.

Në Metodologjinë e Pikëzimit lidhur me këtë tregues përcaktohet se: Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.

Referuar pikës 3, shkronja "e" të vendimit nr. 261/2, datë 14.4.2010 të KLD (Aneksit 1), gjyqtari i dhomës civile të seksionit të përgjithshëm duhet të gjykojë jo më pak se 120 çështje me palë kundërshtare në një vit, i llogaritur 3 vite, jo më pak se 360 çështje civile.

Është përcaktuar një standard orientues lidhur me aspektin sasior për gjykimet e mosmarrëveshjeve... domethënë për mosmarrëveshjet administrative nuk rezulton që është përcaktuar një standard, por vetëm për gjyqtarin e shkallës së parë të dhomës civile që gjykon në seksionin administrativ. Kështu, për analogji, pasur parasysh faktin se jemi përpara gjykimit në apel me natyrë administrative do t'i referohemi standardit sasior të punës së përcaktuar për gjyqtarin e apelit të dhomës civile. Sipas pikës 3 shkronja "i", të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari i gjykatës së apelit i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje civile. Domethënë këtu kemi mbajtur për gjykatën e apelit administrativ, që të ketë gjykuar 200 çështje civile në vit, referuar standardit për gjykimin në apel.

Në lidhje me nga ana e gjyqtares të standardit sasior në fuqi, rezulton si më poshtë vijon :

Në lidhje me periudhën që ka punuar si gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, znj. Mataliaj rezultoi të ketë punuar në dhomën civile (seksioni civile e përgjithshme). Nga të dhënat statistikore rezulton se gjyqtarja ka gjykuar gjatë kësaj periudhë gjithsej 1237 çështje, nga të cilat 549 çështje themeli civile (2 tregtare dhe 2 çështje penale themeli) dhe 441 kërkesa, 254 masa sigurimi. Me statistikat e reja, duke marrë të tre vitet e plota (2013–2014 dhe 2015 sepse në 2016 nuk ka qenë në Gjykatën

e Tiranës) ka rezultuar se ka gjykuar rreth 668 çështje civile themeli, pra rreth 222.7 çështje themeli në vit, ndërsa kërkesa të tjera dhe masa sigurimi ka gjykuar rreth 862 çështje, duke e tejkaluar standardin minimal pothuajse me 100 %, pa përfshirë këtu masat e sigurimit personal të cilat gjykoheshin nga seksioni civil, duke e bërë të pamundur gjyqtarin të gjykojë çështje të tjera gjatë javës së gatishmërisë, ku vetëm gjatë viti 2015 ka gjykuar rreth 164 masa sigurimi personal. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata Administrative e Apelit për efekte të organizimit të shortit, rezulton se për periudhën mars 2016 (15 mars), në fakt periudha e saktësuar pas vërtetimeve të sjella ka rezultuar 01.04.2016 – tetor 2016, pra një periudhë 6 muaj efektive në punë (duke zbritur muajin gusht) gjyqtarja ka përfunduar 257 çështje, ndërsa deri në fund të vitit ka përfunduar 402 çështje. Kështu, rezultoi se gjyqtarja ka përfunduar në Gjykatën Administrative të Apelit (po të marrim përqindjen deri në datën 8.10.2016) ka gjykuar 257 çështje, duke e tejkaluar standardin minimal me 157 çështje dhe duke marrë deri në përfundim të vitit 2016 me 189%.

Pra konstatohet se në çdo vit gjyqtarja e ka tejkaluar standardin minimal të çështjeve të gjykuara brenda një viti, të përcaktuar në vendimin e KLD të sipërcituar, me 100 % gjatë kohës kur ka gjykuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe me 189 % kur ka punuar në Gjykatës Administrative të Apelit.

Në lidhje me aspektin e rritjes së papritur të volumit të çështjeve, rezulton se gjatë kohës që gjyqtarja ka punuar pranë Gjykatës së Tiranës, numri i çështjeve të caktuara për gjykim është ulur, kështu nga viti 2014 i janë caktuar 569 çështje dhe ka gjykuar rreth 485 dhe në vitin 2015, 647 çështje, ku ajo ka përfunduar 629, pra rezulton se ka ardhur me rritjen e ngarkesës edhe rritja e çështjeve të përfunduara. Po të marrim vitin 2013 të plotë, rezulton se e ka ulur sepse në vitin 2013, po ta marrim të plotë, i janë caktuar më shumë.

Në lidhje me aspektin e rritjes së papritur të volumit të çështjeve, rezulton se gjatë vitit 2016 volumi i punës në Gjykatën Administrative të Apelit është rritur ndjeshëm, ku rezulton se gjatë vitit 2016 i janë caktuar 630 çështje administrative vetëm për një periudhë 8–mujore të plotë, fakt ky që ndikon duke tejkaluar standardin prej 189 % për sa kohë ajo ka gjykuar 402 çështje.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit (me statistikat e reja) rezulton në masën 77%, përqindje e cila referuar Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 2 pikë, ndërsa rendimenti i gjyqtares për dy vite të plota kur ajo ka punuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë është mesatarisht 84%. Po kështu sipas të dhënave statistikore konstatohet se ngarkesa sasiore e gjyqtares ka qenë mbi standardin sasior në fuqi si në Gjykatën e Tiranës e cila shkon rreth 600 çështje të caktuara në vit ashtu dhe në Gjykatën Administrative të Apelit, e cila vetëm për një periudhë 8-mujore i janë caktuar rreth 630 çështje. Referuar metodologjisë së pikëzimit, përqindja e rendimentit të gjyqtares për të gjithë periudhën e vlerësimit prej 77% që i korrespondon vlerësimit me 2 pikë, ndërsa po t'i referohemi rendimentit të gjyqtares për dy vitet e plota që ajo ka gjykuar në Gjykatën e Tiranës me 84 %, përqindje që pikëzohet me 4 pikë.

Megjithatë, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse rendimenti i gjyqtares për periudhën e vlerësimit me 84 %, përqindje e cila referuar metodologjisë pikëzohet me 4 pikë, duke marrë në analizë të dhënat e tjera që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) ngarkesën e gjyqtares si relatore në Gjykatën e Tiranës ku për vitin e plotë 2014–2016 (duke përjashtuar vitin 2013), rezulton se ajo ka gjykuar rreth 229 çështje, pasur parasysh që vitin 2019 e kishte të pamundur me statistikat e reja të përcaktoja nga data 8.10. që është periudha e vlerësimit deri në përfundim të vitit pasi një vërtetim që ishte më parë i cili rezultoi që ishte pasaktësi, nuk ishte i plotë, ndërsa statistikat e reja e përfshinin të gjithë vitin, nuk e ndanin deri në datën 8.10. Prandaj është marrë për periudhën e plotë 2014 deri në mars 2016, ku kemi pasur të dhëna të ndara.

Çështjet administrative, siç relatuam, ajo ka tejkaluar rendimentin me mbi 90 e ca % dhe në çështjet administrative me 189 %. Duke marrë edhe numrin total të kërkesave për 3 vitet e plota duke marrë parasysh edhe numrin total të kërkesave të gjykuara çështjeve pa palë kundërshtare, të cilat kanë rezultuar 862 çështje, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet në nivelin maksimal të pikëzimit, duke propozuar që të rritet niveli nga 8 në 10.

Për sa i përket "Koha mesatare e arsyetimit të vendimit", për këtë në fakt gjyqtarja nuk ka pasur kundërshtime, edhe në kushtet kur është pikëzuar maksimalisht.

Referuar Kodit të Procedurës Civile, para ndryshimeve me ligjin 38/2017, afati i dorëzimit të vendimit të arsyetuar në sekretari ishte parashikuar 10 ditë, me përjashtim të rastit kur gjykata vlerësonte shtyrjen e shpalljes së arsyetuar. Në këto kushte në llogaritjen e afatit të dorëzimit mbahet parasysh në rastin konkret afati 10-ditor i arsyetimit të vendimit sipas nenit 308/2.

Ndërsa për sa i përket vendimeve administrative, në nenin 55, pika 3 të Ligjit 49/2012 rezulton se është parashikuar se "7 ditë nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretari".

Referuar çështjeve sipas kategorive të tyre, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar (i) për kategorinë "civile të përgjithshme me pale kundërshtare", është në afatin 10–ditor të përcaktuar në nenin 308/2; (ii) për kategorinë "çështje administrative", është e barabartë me afati 7–ditor, të përcaktuar në nenin 55/3.

Në tërësi, referuar sa më sipër analizuar si në raportin për analizimin e aftësive profesionale të gjyqtares lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, ashtu edhe nga të dhënat e sipërcituara në lidhje me dosjet e shortuara rezulton se në tërësi koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar është më i shkurtër ose i barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve. Për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 15 pikë.

"Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedurat gjyqësore"

Në fakt në raport është analizuar në mënyrë të detajuar secila prej çështjeve të cilat nuk po i lexoj, pasur parasysh se janë goxha të gjata.

Nga tërësia e të dhënave të analizuara, rezulton se vetëm në 7 (shtatë) nga 10 (dhjetë) çështjet e vëzhguara të shortuara dhe një çështje e trajtuar për shkak të ankesave, janë zhvilluar rreth 96 seanca për 8 çështje. Numri mesatar i seancave gjyqësore për të 8 çështjet me palë kundërshtare të analizuara, rezulton të jetë 12 seanca gjyqësore (96 pjesëtim për 8).

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short, evidentohet se gjyqtarja ka kryer me korrektësi dhe efiçencë veprimet procedurale për vënien në lëvizje të dosjeve brenda një kohe të shkurtër nga 0 deri në 12 ditë nga momenti i caktimit të tyre me short. Rezulton se gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të

njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët apo mos zhvillimin i seancave përgatitore dhe gjyqësore për shkak të mungesës së tyre. Konstatohet nga aktet në dosjeve burim vlerësimi se gjyqtarja për çdo çështje ka disponuar me vendim për caktimin e seancës përgatitore apo kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, në referim të nenit 158/a të K.Pr.Civile. Në çështjet civile rezulton se gjyqtarja ka kryer veprime përgatitore përgjithësisht jo efektive, pasi në shumicën e rasteve ato kanë qenë formale, të cilat kanë shkaktuar më pas shtyrjen e seancave gjyqësore apo një numër të lartë të çështjeve, fakt ky i konstatuar edhe në raportin e KLGJ. Megjithatë konstatohet se në disa raste gjyqtarja ka kryer veprime përgatitore efektive, duke disponuar me vendim për t'i lënë kohë palëve për paraqitjen e provave apo duke disponuar në referim të nenit 223 dhe 224 të K.Pr.Civile për marrjen e dokumentacionit nga të tretët apo pala e paditur, gjatë veprimeve përgatitore apo në vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.

Konstatohet se seancat gjyqësore rezultojnë se janë shtyrë për shkaqe të përligjura dhe kryesisht për marrjen e dokumentacionit të nevojshëm për gjykimin nga të tretët; për shkak të mungesës së gjyqtares për arsye shëndetësore; për shkak të mosparaqitjes së palës paditëse dhe përfaqësuesit të saj për shkaqe të përligjura; me kërkesë të palëve për paraqitjen e provave, përgatitjen e konkluzioneve përfundimtare me shkrim, me kërkesë të eksperteve, mosparaqitjes së tyre, përjashtimin e ekspertit dhe për shpalljen e vendimit (konstatohet se në të gjitha vendimet gjyqtarja i ka shtyrë seancat për të shpallur vendimin, nuk e ka dhënë menjëherë por e ka shtyrë për ta shpallur).

Në këtë numër të seancave janë llogaritur i gjithë numri i seancave, duke përfshirë edhe këtë që e ka shtyrë gjyqtarja për ta shpallur të arsyetuar ashtu edhe numri i seancave të cilat janë shtyrë për shkak të mungesës së gjyqtares për arsye të përligjura (konkretisht me raport mjekësor).

Në çdo rast të shtyrjes së seancave gjyqësore, seanca vijuese është planifikuar dhe zhvilluar brenda afateve relativisht të shkurtra, si dhe duke respektuar në çdo rast afatin procedural 5-ditor kur seanca është shtyre për përgatitjen e konkluzioneve me shkrim apo shpalljen e vendimeve sipas përcaktimeve të nenit 305 dhe 308 të K.Pr.Civile.

Referuar sa më sipër, për treguesit e “Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short dhe një çështje të shqyrtuar për shkak ankese, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 12 seanca gjyqësore, dhe po kështu konstatohet që gjyqtarja përgjithësisht ka treguar kujdes për shmangien e seancave joproduktive, por sërish numri i seancave gjyqësore në tërësi dhe numri i seancave joproduktive rezulton i lartë (rreth 46.8 % e seancave të zhvilluara kanë qenë joproduktive, konkretisht janë zhvilluar 96 seanca gjyqësore, nga të cilat 49.2 kanë qenë produktive dhe 45 kanë qenë joproduktive për 8 çështjet, ndërsa vetëm për 7 çështje (duke përjashtuar çështjen e cila ka ardhur për shkak të ankesës) rezulton se numri i seancave është 64, nga të cilat 39 kanë qenë produktive dhe 25 joproduktive, pra në përqindje 39% kanë qenë seanca joproduktive.

Në lidhje me pikëzimin e këtij treguesi, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se të dhënat statistikore analizohen sipas situatës me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit në tërësinë e tyre, veçanërisht masave për zhvillimin me efektivitet dhe produktivitet të seancave gjyqësore në çështjet e përzgjedhura me short, vlerësoj se shkalla e aftësisë për këtë tregues duhet të vlerësohet mesatare, më 9 pikë.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3 për kategorinë e çështjeve me palë kundërshtare, duke arritur në një mesatare prej 12 seanca (duke i marrë të gjitha çështjet pra edhe atë që kanë ardhur për shkak të ankesës) dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është mesatare, gjyqtarja duhet të pikëzohet me 9 pikë.

Edhe për këtë tregues gjyqtarja ka paraqitur kundërshtimet duke pretenduar se të gjitha seancat janë shtyrë për shkaqe të arsyeshme. Megjithatë unë i qëndroj propozimit që kam paraqitur në raportin e vlerësimit, pasi pavarësisht statistikave të cilat janë paraqitur rishtazi nga ana e gjyqtares, nuk vlerësoj se ndikon në numrin e seancave,

pasi në Gjykatën e Tiranës mund të kishim edhe një numër seancash të lartë, përgjithësisht janë të larta, shkojnë 4-6 mesatare, por në këtë rast them që është shumë e lartë dhe nuk mund të arrijmë në një pikëzim ku nuk është 5-6 që mund ta tejkaloja, por më duket goxha e lartë dhe prandaj i qëndroj propozimit për 9 pikë.

Sa i përket "Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor". Në 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, gjyqtarja në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për caktimin e seancës përgatitore nga 1 deri në 12 ditë pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve civile dhe administrative. Seancat përgatitore dhe gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, në përgjithësi mbajtur pa regjistrim audio por dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore, pasi në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është e njohur situata e kësaj gjykate sa i përket infrastrukturës dhe mungesës së numrit të nevojshëm të sallave për zhvillimin e të gjitha gjykimeve në sistem audio. Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se në të gjitha çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtarja është munduar të vejë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën dhe duke urdhëruar njoftimet përkatëse për palët. Veprimet përgatitore përgjithësisht kanë qenë formale, çka ka sjellë më pas zhvillimin e një numri të lartë të seancave gjyqësore. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë përgjithësisht i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile dhe ato administrative (ligji 49/2012 "Për Gjykatat Administrative"). Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtarja tregon kujdes për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të palës së paditur, legjitimimin e mbrojtësit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.). Drejtimi i seancës

zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Në dosje te vëzhguara, konstatohet aftësi e mirë e gjyqtares në drejtim të planifikimit dhe menaxhimit të seancave gjyqësore të cilat përgjithësisht janë çelur në kohën e përcaktuar dhe vetëm në disa raste me vonesa të papërfillshme por duke relatuar gjithnjë shkakun e vonesës (për shkak të qenies në gjykime të tjera).

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë mbi mesataren në këtë tregues, evidentuar në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit civil, në seancat përgatitore (megjithëse këto jo gjithmonë kanë qenë efektive) dhe gjyqësore të zhvilluara.

Referuar sa më sipër, për treguesin "kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor" vlerësohet "mbi mesataren" duke u pikëzuar me 16 pikë.

Edhe për këtë tregues, gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, por unë vlerësoj se jemi në kushtet kur duhet të qëndrojë i njëjti pikëzim pasi ashtu siç është paraqitur edhe në raportin e vlerësimit të KLGJ-së është konkluduar se veprimet përgatitore të kryera nga ana e gjyqtares nuk kanë qenë gjithmonë efektive. Përgjithësisht kanë qenë formale.

"Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore", duke qenë se këtu nuk ka kundërshtime, ka rezultuar që të gjitha aktet kanë qenë të rregullta.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në këtë tregues, për këtë arsye është propozuar pikëzimi i saj me 5 pikë.

"Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes" - Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (vendimet për vënien në lëvizje të çështjes, njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, etj.).

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në këtë tregues.

Për sa më sipër është propozuar vlerësimi i saj me 10 pikë.

Me gjithë propozimet që kam bërë, unë vlerësoj se për këtë tregues, gjyqtarja, referuar provave të reja të paraqitura, duhet të pikëzohet “Shkëlqyeshëm”, me 90 pikë.

“Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”. Për sa i përket “Angazhimit dhe përgjegjësisë në funksion”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka reflektuar angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion dhe propozohet pikëzimi i saj me 35 pikë.

Lidhur me “Integritetin e gjyqtares”, “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti”. Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit. Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke qenë se nuk ka të dhëna për sjellje të pahijshme apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin, propozohet vlerësimi i saj me 40 pikë.

“Paanësia e gjyqtarit” – Nga tre vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe 11 çështjet e përzgjedhura me short, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët. Për këtë arsye, për këtë tregues, vlerësohet aftësia e gjyqtares shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

“Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuara të palëve për përjashtimin e gjyqtares duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Për sa i përket pikëzimit të gjyqtares për këtë kriter, vlerësohet pikëzimi i saj me 100 pikë, niveli i vlerësimit "Shkëlqyeshëm".

Për sa i përket “Aftësisë personale dhe angazhimit profesional”, lidhur me këtë kriter gjyqtarja nuk ka paraqitur kundërshtime, por ka paraqitur prova të reja lidhur me një tregues, të cilat nuk është se ndryshojnë tek pikëzimi. Gjithsesi unë do t’i relatojë edhe provat e reja të paraqitura nga ana e gjyqtares.

Sa i përket “Aftësisë së komunikimit”, në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i saj me 25 pikë.

“Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit. Për këtë arsye, aftësia e saj vlerësohet shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

“Aftësia për të bashkëpunuar” – Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe mungesës të dhënave burimore për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me kolegët, vlerësoj se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i saj me 15 pikë.

“Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore”, edhe për këtë tregues ka mungesë të dhënash për shkallën e komunikimit me gjyqtarët, me administratën gjyqësore. Për këtë arsye vlerësohet se ka shkallë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta. Për këtë arsye propozohet vlerësimi i saj me 10 pikë.

“Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera”, “Pjesëmarrja e gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të shkollës së magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale”. Sipas të dhënave të pasqyruara në vërtetimin me nr. {...} prot., datë 21.10.2016, të lëshuar nga Shkolla e Magjistraturës, në periudhën e vlerësimit 2013–2016, rezulton se gjyqtarja, ka qenë pjesëmarrës në 6 (gjashtë) aktivitete trajnuese të

organizuara nga kjo shkollë të shtrira në 9 ditë trajnimi. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, Ligji nr. 9877, datë 18.2.2008 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ligji "Për Shkollën e Magjistraturës", ka parashikuar që gjyqtari nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë në pesë vite. Pra nuk ka përcaktuar një kufi minimal por vetëm maksimal.

Sa më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtares në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, propozohet me 20 pikë, duke qenë se ka 6 aktivitete trajnuese e shpërndarë me 9 ditë.

"Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale" – Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, është referuar për angazhimin e saj në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si pjesëmarrje në konferenca shkencore, fjalime publike, prezantime në konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare; pjesëmarrja në programet e edukimit të komunitetit; bashkëpunimi me Këshillin për përmirësimin e programeve të formimit vazhdues; angazhimi si ekspert në punët e Këshillit për përgatitjen e formave standarde me qëllim rritjen e efiçencës etj. Konkretisht, rezulton se gjyqtarja ka deklaruar dhe rezulton të ketë marrë pjesë në këto aktivitete:

(i) Pjesëmarrëse dhe referuese në Konferencën Shkencore zhvilluar më datë 13 dhjetor 2013, dhe gjyqtarja ka referuar një punim shkencor.

(ii) Pjesëmarrëse dhe referuese në Konferencën e Dytë Ndërkombëtare "Për Biznesin, Ligjin, Administratën dhe Shkencat Shoqërore" të zhvilluar më datë 4 prill 2015.

(iii) Pjesëmarrëse në Konferencën e Tretë Ndërkombëtare "Mbi të drejtën e biznesit dhe sfidat e administratës drejtë të ardhmes", të zhvilluar më datë 26 shtator 2015.

(iv) Pjesëmarrëse në Konferencën Shkencore "Të drejtat e njeriut në legjislacionin shqiptar vështruar në kontekstin e të drejtës evropiane", të zhvilluar më datë 21-22 dhjetor 2015 (organizuar nga Fakulteti Juridik, në Universitetin Evropian të Tiranës).

(v) Pjesëmarrëse në Konferencën Ndërkombëtare Shkencore "Përafrimi i legjislacionit të BE-së", të Organizuar nga Ministria e Integrimit Evropian dhe Fakulteti i Drejtësisë.

Gjithashtu, siç e relatova më sipër, gjyqtarja ka paraqitur edhe prova të reja lidhur me këtë tregues. Konkretisht, ka paraqitur një vërtetim ku gjyqtarja ka qenë si lektore pranë universitetit privat. Konkretisht ka paraqitur vërtetimin me nr. {...} prot., datë 06.10.2012, ku rezulton se gjatë vitit 2012-2013 është aktivizuar si lektore e ftuar në lëndën "E drejta civile" dhe "E drejta e detyrimeve dhe kontratave". Gjithashtu sipas vërtetimit me nr. {...} prot., datë 06.02.2022, lëshuar nga Dhoma Kombëtare e Noterisë, rezulton se është angazhuar pranë Dhomës Kombëtare të Noterisë gjatë vitit 2014 në rolin e ekspertes për nevojën e ndryshimeve ligjore në fokus "Marrëdhëniet e trashëgimisë", të ligjit për noterinë. Gjithashtu ka dhënë kontributin e saj gjatë realizimit të trajnimeve në mbledhjet e noterëve duke ofruar ekspertimin e saj në lidhje me problematikat e dala gjatë zhvillimit në praktikën e ligjit për noterinë për dispozitat e Kodit Civil që rregullojnë marrëdhëniet juridiko-civile në fushën e trashëgimisë.

Duke qenë se ka të dhëna, ky nëntregues është vlerësuar nga 2 deri në 5 pikë. Pra siç e theksova, të dyja vërtetimet e paraqitura rishtazi nga ana e gjyqtares, i referohen pikërisht këtij treguesi, për të cilin ka pasur të dhëna dhe është vlerësuar maksimalisht.

Sa i përket treguesit "Publikimet ligjore akademike", kanë rezultuar këto të dhëna:

- Botimin me titull "Institucioni i Ekstradimit dhe Standardet Ndërkombëtare për zbatimin e tij në Republikën e Shqipërisë", botuar në Revistën Akademike të Biznesit, Administrimit dhe Shkencave Sociale, Korrik 2015, me numër ISSN.

- Artikullin shkencor me titull "Legal definition of res judicata", botuar në Revistën Evropiane të së Drejtës Publike, botim i evidentuar në një institucion në Rumani, me numër vendimi 828/2007 (janë përcaktuar edhe rregullat të cilat kanë vlefshmërinë).

- Botimin me titull “Bashkëpunimi gjyqësor në Fushën Penale, Kuadri ligjor ndërkombëtar ratifikuar nga Republika e Shqipërisë”, botuar në Revistën Ndërkombëtare për Shkencat Shoqërore, “Vizione”, Gusht 2016, në Shkup, Maqedoni, me numër ISSN.

- Botim me titull “Trajtimi i Dëmeve dhe Praktika e Shpërblimit në Kontratat e Sigurimit të detyrueshëm në Sektorin e Transportit”, botuar Revistën Academic Journal of Interdisciplinary Stydies, Gusht 2015, me bashkautorësi, me numër ISSN.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet me 5 pikë.

Në tërësi, për nivelin e pikëzimit për kriterin e katërt është propozuar niveli i saj "Shkëlqyeshëm", me 98 pikë.

Naureda Llagami: Kriteri i parë është 100.

Irena Plaku: Nuk ka pasur kundërshtime.

Naureda Llagami: Kriteri i dytë “Aftësitë organizative”..

Në total, tek i dyti the, nga 84, propozoj 90.

Irena Plaku: Për sa i përket “Standardit minimal”, tek raporti i vlerësimit, po ta shikoni në faqen përkatëse, ishte bërë një gabim. Nga 4 ishte shkruar 3.

Naureda Llagami: Është lapsus?

Irena Plaku: Është lapsus.

Ka qenë 4. Kështu që propozoj të shkojë 5.

Naureda Llagami: Pra ti ke rritur vetëm 1. Sepse ka qenë lapsus 3, në vend të 4.

Irena Plaku: Po!

Klodian Kurushi: Vetëm diçka. Statistikat e reja kur kanë ardhur?

Irena Plaku: Në datën, mbasi kemi njoftuar raportin.

I ka sjellë gjyqtarja, me firmën e kancelarit të gjykatës.

I ka sjellë bashkë me kundërshtimet e saj, ka sjellë edhe statistikat e lëshuara nga të dyja gjykatat dhe provat që cituam më sipër.

"Koha mesatare që i dedikohet..." është propozuar nga 3 në 5 pikë.

"Rendimenti i përfundimit të çështjeve", nga 8 në 10 pikë.

Ndërsa dy të tjera, megjithëse gjyqtarja ka paraqitur kundërshtime, vlerësoj që të qëndrojë në atë nivel, sepse për mua nuk lidhen me statistikat e reja, për sa kohë që lidhet me numrin e seancave dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme, ku unë e kam vlerësuar (gjithsesi mund ta vlerësoni edhe ju ndryshe), duke qenë se tek numri i seancave, pavarësisht se ajo ka kryer veprime dhe ka marrë masa për shmangien e atyre joproduktive, përsëri numri i seancave ka dalë shumë i lartë.

Gjithashtu edhe tek kryerja e veprimeve të nevojshme, megjithëse gjyqtarja rezulton se i merr veprimet e nevojshme, duke qenë se veprimet përgatitore jo gjithmonë kanë qenë efektive, duke pasur parasysh edhe numrin e lartë të seancave, kam propozuar vlerësimin e saj "mbi mesatare" me 16 pikë. Nuk kam propozime të tjera.

Naureda Llagami: Kaq propozime ke ti si relatore?

Irena Plaku: Po!

Naureda Llagami: Përveç propozimeve që reflektoi vetë relatori pasi ka marrë kundërshtimet, kemi ndonjë propozim tjetër?

Po, Brikena!

Brikena Ukperaj: Nisur nga statistikat e reja të sjella nga gjyqtarja, rezulton një dyfish i çështjeve të shqyrtuara prej saj, pra shkojmë rreth 1500 çështje (Kam bërë një llogaritje unë), shkojmë 1569 çështje të gjykuara në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë dhe 402 çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit Administrativ, pra i bie afërsisht për 3 vite 1971 çështje, që është volum i konsiderueshëm (si relatore, jo si anëtare). 402 çështje i ka përfunduar si relatore (nga prilli 2016 deri në dhjetor të vitit 2016). Të paktën nga statistikat e reja që kanë ardhur në Këshill.

Dukshëm, këto statistika të reja tregojnë që treguesit e rendimentit kanë qenë të kondicionuar nga një numër i paparashikueshëm i çështjeve të reja që shkojnë në Gjykatën e Tiranës. Dua ta ngre këtë diskutim, sepse rendimenti në këtë rast nuk lidhet shumë me punën e gjyqtarit se sa lidhet me punën e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës së Tiranës. Për herë të parë po vlerësojmë gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ku pritshëm rendimenti do dalë shumë i ulët, sepse sado çështje që ato të shqyrtojnë, volumi i çështjeve që shkojnë në këtë gjykatë është shumë i madh. Për këtë arsye unë jam dakord me konkluzionet e relatores për sa i përket reflektimit në treguesit e rendimentit, të standardit dhe të kohës mesatare sepse dukshëm gjyqtari ka qenë i ndikuar nga volumi shumë i madh i punës, por jo vetëm për këtë shkak.

Ndryshe nga vlerësimet e tjera që bëjmë ne 1-vjeçare apo 3-vjeçare, gradimi, për sa i përket standardit dhe kohës mesatare bazohet vetëm në dosjet e shortit. Pra ne nuk kemi një panoramë të përgjithshme të respektimit të standardit apo të kohës mesatare për të gjitha çështjet e gjykuara nga gjyqtarja. Për këtë arsye jam dakord me propozimin e relatores.

Por unë kam një propozim tjetër për sa i përket treguesit të "Numrit mesatar të seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive", dhe pse e them këtë gjë. Ne kemi parë shumë gjyqtarë kur i kemi vlerësuar që kanë pasur një numër shumë të lartë të seancave gjyqësore, madje edhe gjyqtarë me një ngarkesë shumë të ulët pune, për shembull gjyqtarë të shkallës së parë të ish-gjykatës së krimeve të rënda. Seancat gjyqësore vinin me një numër të lartë për shembull për shkak të domosdoshmërisë për të kryer veprimet e domosdoshme procedurale, siç ka qenë një rast kur pritej të merrej një letër porosi dhe kishim 33 seanca gjyqësore. Në atë vlerësim por edhe kur kemi diskutuar metodologjinë, kemi pasur parasysh që thjesht numri i seancave nuk është penalizues për gjyqtarin për sa i përket këtij treguesi, por duhet që në dosjet që shikojmë dhe që analizojmë, gjyqtari t'i ketë marrë të gjitha masat për shmangien e seancave joproduktive.

Dukshëm në numrin e seancave rezulton të ketë ndikuar një çështje që është verifikuar nga ish-Inspektorati i KLD-së, vetëm ajo e cila ka rritur në mënyrë artificiale ngarkesën. Nëse do të analizojmë të gjitha çështjet që ne kemi burim vlerësimi sot,

numri mesatar i seancave për çështje ka qenë 7 seanca. (64:7, afërsisht 7 seanca). Duket që të gjitha këto kanë qenë të kondicionuara nga këto 32 seanca që ka pasur kjo çështje.

Nga ana tjetër, ish-Inspektorati e ka referuar për vlerësimin etik dhe profesional, por të vetmin shkak që ka gjetur në këto seanca është fakti që gjyqtarja duhet t'i kishte lënë seancat jo mbi 1 muaj, pra duhet t'i kishte lënë më pas se 1 muaj. Çështja është gjykuar për 4 vjet në total, por ka qenë për më shumë se 2 vite e pezulluar, ndërkohë që dukshëm rezulton që të ketë qenë komplekse. Për këtë arsye vlerësoj që numrin e seancave të mos e përfshijmë në vlerësimin e shkallës së aftësisë së gjyqtares, të mos përfshihet, jo si numër matematikor, por si interpretim logjik, numri i seancave të çështjes së referuar për vlerësim. Duke marrë shkas që në fakt gjyqtarja i ka marrë të gjitha masat për shmangien e seancave joefektive, me përjashtim të kryerjes formale të veprimeve përgatitore.

Ç'ndodhte përpara ndryshimeve me ligjin e 2017 në Kodin e Procedurës Civile?

Kodi i Procedurës Civile, përpara 2017, në një farë mënyre, edhe qëndrimet e gjykatave më të larta, e lejonin gjyqtarin që të merrte prova edhe gjatë gjykimit dhe shpeshherë gjykimet shtyheshin për caktim eksperti, dërgimin e mendimit, dëgjimin e ekspertit, debatimin e raportit të ekspertimit; në qoftë se pala kërkonte paraqitjen e një prove, detyrimisht do e shtyjë, sepse kishte një risk të prishjes nga apeli. Pra nuk e normonte në mënyrë të detyruar siç e bën sot Kodi i Procedurës Civile. Kur kemi bërë metodologjinë, kemi pasur parasysh këtë gjë. Në të gjitha vlerësimet dhe gradimet për gjyqtarët, para ndryshimeve, kemi qenë më diskrecional, në kuptimin që, dakord Kodi e parashikonte, por ti kishe mundësi që këtë veprim ta bëje edhe gjatë gjykimit. Kam përshtypjen që nëse do të miratojmë sot këtë projektraport dhe do themi që vetëm për shkak të numrit të seancave dhe për shkak se nuk kryen veprime përgatitore efektive, gjyqtarja do të ulet edhe tek ky vlerësim, duhet pastaj të reflektojmë edhe tek vlerësimet e tjera që mund të kemi në të ardhmen. Prandaj unë vlerësoj që për aftësinë që ka treguar gjyqtarja, "të penalizohet" vetëm tek kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, por jo për numrin e lartë të seancave dhe shmangien e seancave joefektive. Prandaj propozoj, për shkak të këtij arsyetimi, që ky tregues, nga 9 duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Irena Plaku: Doja të shtoja diçka.

Për sa i përket gjykatës së Tiranës unë jam e vetëdijshme që asnjëherë nuk mund të arrijë as 85% të rendimentit, asnjë gjyqtar, sidomos tek seksioni civil, sepse kanë një ngarkesë shumë të madhe dhe natyra e çështjeve është shumë herë më e vështirë se të gjithë gjykatat e rretheve (duke qenë se kam punuar edhe në gjykatën e rretheve dhe për këtë jam e bindur). Por duke qenë një numër tejet i lartë i seancave, natyralisht kjo e ndikuar vetëm tek çështja e cila është referuar për vlerësim dhe ajo e rrit ndjeshëm. Sepse po të shikojmë edhe standardet minimale, përsëri kjo çështje ka ndikuar që të rritet aq shumë edhe standardet edhe koha mesatare (është një çështje që ndikon ndjeshëm), se po të shikosh çështjet e tjera nuk kanë qenë një standard i tillë. Por duke qenë se edhe ajo çështje është burim vlerësimi, unë e kam konsideruar si gjithë të tjerat dhe për këtë arsye kam vlerësuar që të mos ndryshoj pikëzimin. Gjithsesi, për rendimentin them që është problematike gjithmonë Gjykata e Tiranës dhe nuk do jetë asnjëherë si gjykatat e tjera. Faleminderit!

Naureda Llagami: Propozim tjetër kemi?

Nëse jo, kalojmë fillimisht në votimin e propozimeve të relatores, pastaj propozimin e Brikenës.

Relatori ka propozuar në “Plotësimin e standardeve minimale kohore”, nga 4 në 5 pikë.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Naureda Llagami: Kalojmë në propozimin e dytë që ka të bëjë me "Kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje", nga 3 pikë (propozimi i relatores t'i shtohen 2 pikë) të shkojë në 5 pikë.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Kalojmë tek propozimi i tretë i relatores "Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore", nga 8 pikë në 10 pikë (t'i shtohen 2 pikë).

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Naureda Llagami: Kaq ishin propozimet e relatores.

Kalojmë në propozimin që ka bërë zonja Ukperaj, që ka të bëjë me "Numrin mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive". Zonja Ukperaj propozon nga 9, t'i shtohen 6 pikë, në 15. Pra ngritjen e një niveli.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Kundër.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Kundër.

Brikena Ukperaj: Dakord.

Klodian Kurushi: Kundër. (*Vota e zotit Kurushi nuk dëgjohet në audio, por për efekt të procesverbalit, gjatë zbardhjes së tij, i vënë në dijeni për faktin, e ka konfirmuar atë nëpërmjet e-mailit. Cit. "Vota ime në këtë rast ishte kundër propozimit të bërë nga znj. Ukperaj. Në këtë rast, jam dakordësuar me propozimin e bërë nga relatorja znj. Plaku". E-maili me konfirmimin e votës së tij i bashkëlidhet procesverbalit të sigluar.)*

Naureda Llagami: Dakord.

(Miratohet me shumicën e votave.)

Naureda Llagami: Atëherë, kalojmë në tërësi raportin, ku në tërësi janë 394 pikë.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Dakord, duke qenë se u votua në shumicë.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e "Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016", duke e vlerësuar atë si më poshtë:

A. Aftësitë profesionale – "Shkëlqyeshëm";

B. Aftësitë organizative – "Shkëlqyeshëm";

C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – "Shkëlqyeshëm";

D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – "Shkëlqyeshëm".

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – "Shkëlqyeshëm".

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Vijojmë mbledhjen plenare me dyer të mbyllura për shkak të shqyrtimit të dy relacioneve që kanë të bëjnë me kandidatët magjistratë.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor